Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

Nëntor 2015

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI *7*

1. FJALA E GUVERNATORIT *9*

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË *12*

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE *15*

3.1. Zhvillimet në tregjet financiare *15*
3.2. Normat e interesit të depozitave dhe kushtet e financimit në ekonomi *18*
3.3. Kreditimi i ekonomisë *21*
3.4. Ecuria e treguesve monetarë *26*

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE *29*

4.1. Ambienti i jashtëm i ekonomisë *29*
4.2. Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate *34*
4.3. Gjendja ciklike e ekonomisë *51*
4.4. Ecuria e inflacionit *51*

SHTOJCA STATISTIKORE *57*

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1: Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues, tremujori i tretë 2015 20
Hapësirë informuese 2: Procesi i pastrimit të bilancit të bankave 22
Hapësirë informuese 3: Masat e marra për nxitjen e kreditimit 24
Hapësirë informuese 4: Ecuria e çmimeve në tregun e banesave 38
Hapësirë informuese 5: Matja e pasigurisë ekonomike dhe lidhja me konsumin dhe investimet 43
Hapësirë informuese 6: Zhvillimet në bilancin e pagesave në tremujorin e dytë të vitit 2015 49

PËRMBAJTJA E TABELAVE

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Tabelë 1. Ndryshimet vjetore të kredisë sipas agjentëve ekonomikë, monedhës dhe qëllimit 22
Tabelë 2. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë 30
Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit 32
Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave 50
Tabelë 5. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje) 52

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2. Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë
Grafik 1. Normat e interesit në ekonomi 13
Grafik 2. Inflacioni, norma bazë dhe objektivi (majtas). Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (djathtas) 13

3. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare
Grafik 3. Operacionet e tregut të hapur të Bankës së Shqipërisë dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar 16
Grafik 4. Yield-et e titujve të borxhit publik në tregun primar 16
Grafik 5. Ndryshimet vjetore të indekseve të kursit nominal dhe real të këmbimit; ecuria e kursit Eur/Lek dhe Usd/Lek 18
Grafik 6. Normat e interesit të depozitave të reja 19
Grafik 7. Normat e interesit për kredinë e re 19
Grafik 8. Ecuria e standardeve dhe e kërkesës së bizneseve për kredi 20
Grafik 9. Ecuria e standardeve dhe e kërkesës së individëve për kredi 21
Grafik 10. Kredia sipas agjentëve ekonomikë dhe monedhës 23
Grafik 11. Kredia sipas qëllimit të përdorimit 24
Grafik 12. Ecuria e treguesve monetarë 27
Grafik 13. Zhvillimet në depozita 27

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Grafik 14. Indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike (djathtas) 30
Grafik 15. Ndryshimet vjetore të çmimeve bazë 32
Grafik 16. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 33
Grafik 17. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 33
Grafik 18. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së 35
Grafik 19. Prodhimi i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 36
Grafik 20. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 36
Grafik 21. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim 37
Grafik 22. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre 38
Grafik 23. Tregues nga vrojtimi i besimit të ndërtimit (majtas) dhe nga vrojtimi i aktivitetit kreditues (djathtas) 38
Grafik 24. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 39
Grafik 25. Struktura e kërkesës së brendshme (kontribute në ndryshimin vjetor të saj) dhe treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100) 40
Grafik 26. Ecuria e konsumit privat dhe besimit në sektorin e tregtisë 41
Grafik 27. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e tretë 41
Grafik 28. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 42
Grafik 29. Tregues afatshkurtër të investimeve private për tremujorin e dytë dhe të tretë 42
Grafik 30. Treguesit e pasigurisë ekonomike (TPE) të matura nga shpërndarja e pritjeve dhe nga gabimi në parashikim 44
Grafik 31. TPE-të e bizneseve dhe rritja vjetore e investimeve, grafiku majtas dhe TPE-të e konsumatorëve dhe rritja vjetore e konsumit privat, grafiku djathtas 44
Grafik 32. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar 45
Grafik 33. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve dhe zërave kryesorë (majtas), kontributi i përbërësve kryesorë të shpenzimeve tek shpenzimet totale (djathtas) 46
Grafik 34. Ndryshimi vjetor i zërave kryesorë të të ardhurave (majtas) dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave, sipas kontributeve të zërave kryesorë (djathtas) 47
Grafik 35. Deficiti kumulativ / PBB (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në mld lekë (djathtas) 47
Grafik 36. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindjeje) 48
Grafik 37. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë) 48
Grafik 38. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë 51
Grafik 39. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 52
Grafik 40. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas) 53

Grafik 41. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit 53
Grafik 42. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas) 54
Grafik 43. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë 55

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0 për qind në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i Politikës Monetare për tremujorin e tretë të vitit 2015 u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 04.11.2015. Analiza ekonomike, financiare dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 23 tetor 2015.

1. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare vazhdon të lëvizë në një trajektore pozitive zhvillimi. Megjithatë, kërkesa agregate, prodhimi dhe punësimi, janë poshtë niveleve të tyre potenciale dhe presionet afatmesme mbi inflacionin mbeten të dobëta.

Informacioni i ri ekonomik dhe financiar ka qenë në linjë me parashikimet tona, por rritja ekonomike dhe ecuria e kredisë kanë rezultuar në kahun e poshtëm të tyre. Ambienti i jashtëm paraqitet ende sfidues dhe burimet e brendshme të rritjes ekonomike shfaqen ende të pakonsoliduara. Gjithashtu, rritja e shpejtë e inflacionit gjatë muajve të fundit duket se i detyrohet në masën më të madhe goditjeve afatshkurtra të ofertës.

Ecuria e pritur e zhvillimeve ekonomike dhe monetare ruan një profil përafërsisht të ngjashëm me atë të parashikimeve tona paraardhëse. Në horizontin afatmesëm, Banka e Shqipërisë pret një kthim gradual të inflacionit në objektiv, të mbështetur nga përmirësimi progresiv i rritjes ekonomike. Megjithatë, në ndryshim nga parashikimet paraardhëse, projeksionet aktuale sugjerojnë se kthimi i ekonomisë në ekuilibër dhe i inflacionit në objektiv do të kërkojë një kohë disi më të gjatë. Gjithashtu, këto projeksione sugjeruan nevojën për forcimin e stimulit monetar në ekonomi, për të nxitur më tej kërkesën e brendshme dhe për të forcuar më tej kanalin e kredisë.

Në përputhje me këto parashikime, me shqyrtimin e këtij raporti, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 1.75%.

Inflacioni pritet të vijë në rritje progresive gjatë horizontit afatmesëm.

Inflacioni mesatar i tremujorit të tretë rezultoi në nivelin 1.8%. Kjo normë ishte e ngjashme me atë të tremujorit paraardhës, por inflacioni regjistroi luhatje të ndjeshme brenda periudhës. Në pjesën më të madhe, këto luhatje u ndikuan nga ecuria e çmimeve të produkteve ushqimore.

Rritja e ngadaltë e inflacionit pasqyron kapacitetet e pashfrytëzuara të prodhimit, tendencën rënëse të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe pritjet e moderuara për inflacionin. Për rrjedhojë, inflacioni bazë vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta.

Analiza e informacionit të disponuar sugjeron se në periudhën afatshkurtër presionet inflacioniste do të vijojnë të mbeten të ulëta. Inflacioni mesatar i vitit 2015 pritet të luhatet rreth nivelit 2% dhe ai i vitit 2016 pritet të luhatet rreth

nivelit 2.2%. Në afat të mesëm, inflacioni parashikohet të vijë në rritje dhe të kthehet në objektivin tonë prej 3% brenda tremujorit të parë të vitit 2018.

Gjallërimi gradual i ekonomisë do të jetë faktori kryesor për kthimin e inflacionit në objektiv.

Aktiviteti ekonomik regjistroi rritje vjetore prej 2.5% në tremujorin e dytë, duke rezultuar afër parashikimeve tona. Rritja ekonomike u mbështet nga investimet dhe nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë. Në të kundërt, konsumi privat u reduktua, si pasojë e forcimit të prirjes për kursim të familjeve. Të dhënat e disponuara sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të regjistrojë norma të ngjashme rritjeje edhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në këtë periudhë do të udhëhiqet në masën më të madhe nga rritja e investimeve dhe nga përmirësimi i bilancit tregtar.

Ekonomia shqiptare pritet të shënojë përmirësime të mëtejshme në afat të mesëm. Përshpejtimi i aktivitetit ekonomik pritet të mbështetet nga lehtësimi i kushteve të financimit, nga reduktimi i pasigurive dhe nga përmirësimi i ambientit të huaj. Rritja ekonomike do të financohet nga përdorimi i kursimeve të akumuluara të sektorit privat dhe nga hyrjet e kapitalit të huaj. Gjithashtu, zgjerimi i aktivitetit ekonomik pritet të gjejë mbështetje në rritje nga kredia bankare në gjysmën e dytë të horizontit të parashikimit.

Një impuls i ri monetar do të mbështesë më mirë konsumin, investimet dhe aktivitetin kreditues.

Tregjet financiare shqiptare rezultojnë likuide dhe aktiviteti në to paraqitet i stabilizuar. Sistemi bankar shqiptar përballoi me sukses sfidat e paraqitura nga turbulenca financiare në vendin fqinj. Megjithatë, agjentët financiarë vazhdojnë të shfaqin një oreks të ulët për rrezik dhe gatishmëri të pakët për financimin e projekteve afatgjata.

Politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë i ka sjellë normat e interesit të kredive në nivele minimale historike dhe ka nxitur kërkesën për kredi. Në përgjigje të saj, portofoli i kredisë në lekë ka vazhduar të shfaqë një ecuri pozitive; norma vjetore e rritjes së këtij portofoli qëndroi në nivelin 5.2% në muajin gusht, ndërkohë që pesha e tij ndaj kredisë totale u rrit në nivelin 41%.

Megjithatë, aktiviteti kreditues mbetet ende i zbehtë, sidomos në drejtim të financimit të biznesit dhe në segmentin e kredive në valutë. Rritja vjetore e portofolit të kredisë u reduktua rreth nivelit 1% në muajin gusht. Ky reduktim u ndikua si nga kërkesa e ulët e bizneseve për financim, ashtu edhe nga kushtet e shtrënguara të ofertës së bankave për kredi. Gjithashtu, pagimi i detyrimeve të prapambetura nga sektori publik ka ofruar një burim alternativ likuiditeti dhe financimi për bizneset, duke sjellë një efekt të përkohshëm shtesë në rënien e kërkesës për kredi.

Analizat dhe parashikimet e këtij raporti kanë ilustruar nevojën për rritjen e stimulit monetar në ekonomi, dhe për ruajtjen e tij për një periudhë kohore më të gjatë sesa vlerësimet tona të mëparshme. Bazuar në këto konsiderata, Banka e Shqipërisë gjykon se kahu i politikës monetare do të vazhdojë të jetë lehtësues, përgjatë gjithë vitit 2016. Gjithashtu, zbatimi i shpejtë i planit të dakorduar të masave për parandalimin dhe zgjidhjen e kredive me probleme, mbetet një prioritet madhor me qëllim reduktimin e rrezikut të perceptuar të kreditimit në Shqipëri.

Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe afatgjatë duhet të mbështetet nga vazhdimi e thellimi i reformave strukturore.

Banka e Shqipërisë vlerëson se stimuli monetar ofron kohën e nevojshme për kryerjen e reformave strukturore dhe zbut koston e këtyre reformave në ekonomi, por ai nuk është në gjendje të sigurojë rritje afatgjatë ekonomike dhe nuk duhet parë si një zëvendësues i tyre.

Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë rithekson nevojën për vazhdimin dhe përshpejtimin e reformave strukturore. Këto reforma duhet të synojnë përmirësimin e qëndrueshëm të klimës së biznesit, rritjen e produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike e financiare të vendit.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet në përmbushje të objektivit të stabilitetit të çmimeve. Dobësia ciklike e ekonomisë dhe presionet e dobëta inflacioniste kanë kërkuar ndjekjen e një politike monetare stimuluese gjatë 4 viteve të fundit. Kjo politikë synon: (i) të ulë kostot e financimit në ekonomi dhe të stimulojë kërkesën, nëpërmjet rritjes së konsumit dhe të investimeve; (ii) të përmirësojë fluksin e parasë të agjentëve ekonomikë, duke çliruar fonde financiare të cilat mund të përdoren po ashtu për rritje konsumi e investimesh; dhe, (iii) të mbajë të ankoruara pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, politika monetare lehtësuese stimulon përmirësimin e bilancit tregtar, duke ofruar një kanal tjetër për rritjen e kërkesës agregate.

Rikthimi i aktivitetit ekonomik në parametrat e vet potencialë do të krijojë kushtet e duhura për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv. Përmbushja e këtyre objektivave, kërkon ndjekjen e një politike monetare stimuluese edhe për disa tremujorë në vazhdim.

Politika monetare ka vijuar të jetë lehtësuese, në përputhje me angazhimin e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e normave të ulëta të interesit edhe për disa tremujorë. Pas uljes së fundit në muajin janar, norma bazë e interesit ka vazhduar të qëndrojë në nivelin minimal historik prej 2.0%. Gjatë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë ka vijuar të injektojë likuiditet në treg me anë të operacioneve të rifinancimit të sistemit bankar, duke ofruar një tjetër kanal për lehtësimin e kushteve monetare. Për të forcuar kahun lehtësues të politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka komunikuar në vazhdimësi angazhimin për ruajtjen e normës së interesit në nivele të ulëta, deri në rikthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv. Kjo formë komunikimi i ka shërbyer uljes së pasigurisë në ekonomi dhe përcjelljes më të mirë të politikës monetare në tregjet financiare.

Politika monetare është reflektuar në tregjet financiare, edhe pse primet e perceptuara të rrezikut vazhdojnë të mbeten të larta dhe oreksi për kredi vazhdon të jetë i ulët. Lehtësimi i politikës monetare është pasuar nga rënia në nivele minimale historike e normave të interesit të huamarrjes në monedhën vendase. Në përgjigje të kësaj, kredia në lekë vazhdon të shënojë rritje, ndërkohë që portofoli i kredisë në valutë ka ardhur në rënie. Po kështu, normat e interesit të letrave me vlerë të qeverisë janë në minimumet e tyre historike, duke lehtësuar shërbimin e borxhit publik dhe privat. Së fundi, edhe normat e interesit të depozitave janë në nivelet e tyre më të ulëta, duke inkurajuar kështu rritjen e konsumit privat.

Grafik 1. Normat e interesit në ekonomi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndonëse kostot e financimit në ekonomi janë të favorshme, rritja e kredisë shfaqet e zbehtë dhe biznesi e konsumatori shqiptar nuk janë treguar të gatshëm apo në gjendje të përfitojnë prej tyre. Kjo situatë diktohet nga primet e rrezikut të perceptuar nga agjentët e brendshëm ekonomikë dhe financiarë, nga zhvillimet ende problematike në partnerët tanë kryesorë tregtarë, si dhe nga politikat ende konservatore të ndjekura nga sistemi bankar evropian.

Aktiviteti ekonomik në vend mbetet poshtë nivelit potencial dhe presionet e brendshme afatgjata inflacioniste janë të ulëta. Nga ana tjetër, edhe tregjet botërore karakterizohen nga nivele të moderuara inflacioni për lëndët e para dhe për produktet e gatshme.

Inflacioni mesatar i tremujorit të tretë rezultoi në nivelin 1.8%, duke shënuar një vlerë thuajse të njëjtë me atë të tremujorit të kaluar dhe duke qenë në linjë me

Grafik 2. Inflacioni, norma bazë dhe objektivi (majtas). Hendeku i prodhimit dhe inflacioni bazë (djathtas)*



* Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve dhe mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

parashikimet e Bankës së Shqipërisë. Ai përjetoi një rënie të dukshme në muajin korrik, për t'iu kthyer vlerave më të larta gjatë muajve gusht-shtator. Luhatjet në inflacion u shkaktuan nga faktorë afatshkurtër të ofertës, të lidhur kryesisht me lëvizjen e çmimeve të ushqimeve. Në prani të një aktiviteti ekonomik të ngadaltë dhe nën potencialin e tij, inflacioni bazë mbetet i ulët.

Ekonomia shqiptare u rrit me 2.5% në tremujorin e dytë të vitit, e mbështetur nga rritja e investimeve dhe nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve me partnerët tregtarë. Rritja ekonomike e kësaj periudhe rezultoi në kahun e poshtëm të parashikimeve tona, duke ilustruar brishtësinë e kërkesës agregate dhe të rritjes ekonomike.

Zhvillimet më të fundit ekonomike e financiare nuk kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme kahun, dinamikat dhe intensitetin e zhvillimeve të pritura. Rritja ekonomike pritet të forcohet gjatë vitit 2016 e më tej. Kompozimi i saj pritet të jetë më i balancuar, duke u mbështetur si nga kërkesa e brendshme, ashtu edhe nga ajo e huaj. Kërkesa e brendshme pritet të përfitojë nga normat e ulëta të interesit, nga përmirësimi i kushteve të financimit, nga reduktimi i pasigurisë dhe nga rritja e prirjes për konsum. Rritja e kërkesës së brendshme private pritet të gjenerojë një aktivitet ekonomik të mjaftueshëm për të absorbuar kapacitetet e pashfrytëzuara të prodhimit, pavarësisht politikës fiskale konsoliduese dhe pasigurive të shumta për rritjen ekonomike në tregjet partnere. Hendeku negativ i prodhimit parashikohet të mbyllet gradualisht përgjatë vitit në vijim, duke kaluar në kahun pozitiv në fillim të vitit 2017.

Megjithatë, ecuria ende e dobët e ekonomisë dhe e tregjeve financiare evropiane, pasiguria e shfaqur nga agjentët ekonomikë në vend dhe problemet që vazhdojnë të karakterizojnë rritjen e kreditimit, kanë sjellë një rishikim të lehtë për poshtë të ritmeve të pritura ekonomike për vitin 2016. Për rrjedhojë, parashikimet tona për kthimin e ekonomisë në ekuilibër dhe të inflacionit në objektiv janë shtyrë lehtësisht në kohë.

Në krahasim me parashikimet e tremujorit të kaluar, në vlerësimet e reja, hendeku negativ i prodhimit mbyllet më vonë, si pasojë e pritjeve për një rritje më të ngadaltë ekonomike gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016. Përmirësimi më i ngadaltë ciklik i ekonomisë vlerësohet të shoqërohet me kthimin e inflacionit në objektiv në fillim të vitit 2018. Në horizontin afatshkurtër të katër tremujorëve të ardhshëm, inflacioni mesatar pritet të luhatet rreth nivelit 2.3%.

Parashikimet e mësipërme janë të kushtëzuara dhe faktorizojnë një stimul më të lartë monetar në ekonomi në periudhën afatshkurtër. Gjithashtu, kthimi i ekonomisë në ekuilibër dhe i inflacionit në objektiv do të kërkojë ruajtjen e një politike monetare stimuluese gjatë gjithë horizontit afatmesëm të parashikimit. Intensiteti i stimulit monetar nuk do të dobësohet gjatë vitit 2016. Duke u nisur nga informacioni i disponuar, Banka e Shqipërisë gjykon se cikli rritës i normave të interesit nuk do të fillojë më herët se viti 2017.

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

Tregjet financiare vazhdojnë të karakterizohen nga një situatë e mirë likuiditeti. Ngjarjet në Greqi nuk shkaktuan luhatje apo pasoja në tregun e brendshëm financiar, ndërsa normat e interesit kanë treguar ulje të mëtejshme në përgjigje të politikës monetare lehtësuese. Ecuria e kursit të këmbimit ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme, me një tendencë mbiçmimi në muajin shtator.

Muajt korrik-gusht evidentuan një ecuri të dobët të kreditimit, pavarësisht lehtësimit të kushteve të financimit. Kredia vijon të ndikohet si nga kërkesa e ulët për kredi, ashtu dhe nga politikat konservatore të bankave në kredidhënie. Zgjerimi i mjeteve monetare mbetet i ulët dhe nuk sinjalizon për presione të larta inflacioniste në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Banka e Shqipërisë pret një situatë të ngjashme edhe për pjesën e mbetur të vitit.

Nga ana tjetër, normat e interesit pritet të mbeten në nivele të ulëta historike, duke mbështetur kërkesën për kredi. Gjithashtu, përmirësimi i pritur i kushteve të financimit në përgjigje të reduktimit të rrezikut të perceptuar të kredisë, do të nxisë interesin e bankave për kredidhënie. Kreditimi pritet të rezultojë i dobët deri në fund të vitit 2015. Ai pritet të rikuperohet gjatë vitit 2016 dhe në vazhdim, duke mbështetur më mirë përmirësimin e aktivitetit ekonomik në afat të mesëm.

3.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Tregu ndërbankar

Normat e interesit në tregun ndërbankar nuk kanë ndryshuar nga tremujori i kaluar, ndërsa vëllimi i tregtuar është ulur lehtë në tremujorin e tretë.[1] Bankat kanë vijuar përqasjen afatshkurtër ndaj këtij tregu, ku maturiteti i transaksioneve përqendrohet kryesisht tek segmenti ditor dhe javor. Normat e interesit kanë vijuar të pozicionohen poshtë normës bazë, ndërkohë që treguesit e luhatshmërisë nuk paraqesin ndryshim nga tremujori i kaluar.[2] Interesi prej 1.93% për shkëmbimet ditore ka rezultuar afërsisht i njëjtë me atë të tremujorit të dytë (1.92%). Për maturitetin javor, interesi ka regjistruar një ulje prej 0.04 pikë përqindjeje, duke zbritur në të njëjtën vlerë me interesin ditor. Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione injektuese likuiditeti në sistem, me anë të instrumentit të saj kryesor (repo 7-ditore), si dhe me anë të marrëveshjeve të anasjella repo, me maturitet 1 dhe 3-mujor. Shuma e injektuar këtë periudhë ka qenë më e lartë

[1] *Vëllimi total rezultoi 6.8 miliardë lekë nga 7.5 miliardë në tremujorin e dytë.*

[2] *Devijimi standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për tremujorin e tretë rezultoi 0.0841 nga 0.0842 në tremujorin paraardhës.*

se tremujorin e kaluar. Ajo ka reflektuar jo vetëm nevojat e bankave, por edhe politikën e Bankës së Shqipërisë për të ulur rrezikun e likuiditetit në sistem, nga situata e paqartë e krijuar në Greqi në muajt qershor-korrik.

Grafik 3. Operacionet e tregut të hapur të Bankës së Shqipërisë dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, tregu ndërbankar vijon të ketë peshë të ulët në aktivet e sistemit bankar. Bankat tregojnë gatishmëri të ulët për ta përdorur këtë segment për qëllime tregtimi dhe sigurim të fondeve.[3]

Tregu primar

Me përjashtim të segmentit afatshkurtër, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë lëvizur pak nga nivelet e tremujorit të dytë. Në qëndrueshmërinë e tyre kanë kontribuar si likuiditeti i mjaftueshëm në treg, ashtu edhe ruajtja e balancës së kërkesës dhe ofertës për fonde. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja në ankandet

Grafik 4. *Yield*-et e titujve të borxhit publik në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[3] *Vëllimi i huamarrjes në tregun ndërbankar llogaritet të jetë rreth 1.0% e totalit të aktiveve të sistemit bankar.*

e obligacioneve në lekë ka qenë më e ulët, ndërkohë që është vërejtur një pjesëmarrje e shtuar për instrumentet e emetuara në euro[4].

Yield-et e bonove të thesarit 3- dhe 6-mujore kanë vijuar të ulen edhe në tremujorin e tretë (përkatësisht në 2.60% dhe në 2.87% në ankandet e shtatorit), ndikuar nga emetimet më të ulëta për këto maturitete. *Yield*-i 12-mujor ka ngadalësuar rënien dhe ka qëndruar pranë nivelit 3.21% që prej mesit të muajit gusht. Në ankandet e obligacioneve, *yield*-i 10-vjeçar shënoi 8.90% në muajin korrik, nga 8.93% në ankandin paraardhës të prillit. Në muajin gusht, ai 5-vjeçar mbeti i pandryshuar në nivelin 6.45%. *Yield*-i 2-vjeçar ka regjistruar rënie graduale, duke shënuar 4.59% në fund të muajit shtator ose 11 pikë bazë më pak se në fund të tremujorit të dytë. Gjithashtu, ankandet e obligacioneve me normë interesi të ndryshueshme, kanë shfaqur marzhe më të ulëta (marzhet 5 dhe 10-vjeçare shënuan 2.51% dhe 3.15%, duke rënë përkatësisht me 2 dhe 3 pikë bazë nga ankandet paraardhëse).

Gjatë këtij tremujori u zhvilluan edhe ankandet për emetimin e letrave me vlerë në monedhën euro, ku kërkesa ishte dukshëm më e lartë për instrumentet afatgjata. Në korrik, ankandi i instrumentit 12-mujor rezultoi i paplotësuar dhe *yield*-i shënoi 2.26% nga 2.34%, që ishte në fund të vitit 2014. Në muajin gusht u zhvillua ankandi për obligacionin 2-vjeçar, i cili rezultoi i mbikërkuar me gati dyfishin e shumës së shpallur.[5] Në shtator ky ankand u rihap, duke rezultuar sërish i mbikërkuar.

Tregu valutor

Monedha vendase ka frenuar ritmet nënçmuese në tremujorin e tretë. Sipas indeksit të kursit nominal efektiv të këmbimit (KNEK)[6], leku u nënçmua lehtësisht, me 0.9%, në terma vjetorë. Pas ngadalësimit të normave nënçmuese në muajt korrik dhe gusht, monedha vendase shënoi një pikë kthese në muajin shtator, duke u mbiçmuar me 0.7%. Kjo sjellje u kushtëzua si nga qëndrueshmëria e raportit Eur/Lek, ashtu edhe nga mbiçmimi i nënkuptuar i lekut ndaj lirës turke[7]. Mbiçmimi i lekut në terma realë, rezultoi edhe më i lartë se ai në terma nominalë (1.9% v-m-v). Inflacioni në pothuajse të gjitha vendet partnere u pozicionua poshtë atij të regjistruar në vend.

---

[4] *Në përputhje me kalendarin e emetimeve, në fund të muajit korrik, u emetuan bono thesari në euro, ndërsa në fund të gushtit u emetuan obligacione 2-vjeçare në euro.*

[5] *Pjesëmarrja e individëve në këtë ankand ishte e konsiderueshme, duke përbërë 43% të shumës së fituar.*

[6] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (ang. NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë, të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina. Një rritje e tij nënkupton nënçmim të lekut.*

[7] *Për të llogaritur kursin lira/lek, përdoret kursi zyrtar i lirës turke ndaj dollarit amerikan. Lira turke është nënçmuar në terma vjetorë ndaj dollarit amerikan me 32%, ndërkohë që nënçmimi i lekut ka qenë mesatarisht 14.6%. Si rezultat, monedha vendase është mbiçmuar ndaj lirës turke me 16% v-m-v, duke ndikuar ecurinë e lekut në terma nominalë dhe realë, pavarësisht peshës prej 10% të aktivitetit tonë tregtar me Turqinë.*

Grafik 5. Ndryshimet vjetore të indekseve të kursit nominal dhe real të këmbimit; ecuria e kursit Eur/Lek dhe Usd/Lek



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kursi mesatar i këmbimit Eur/Lek rezultoi në nivelin 139.7, në tremujorin e tretë ose 0.1% më pak se vitin e kaluar. Në terma tremujorë, leku u mbiçmua në mënyrë modeste me 0.5%, duke përcjellë sezonalitetin karakteristik të periudhës. Monedha vendase ka vijuar të nënçmohet ndaj dollarit amerikan, ndonëse me ritme më të moderuara, si rrjedhojë edhe e efektit bazë. Nënçmimi në terma vjetorë rezultoi mesatarisht 19.1%, ndërkohë që në raport me tremujorin e dytë, leku u mbiçmua ndaj dollarit amerikan me 1.2%.

3.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT NË EKONOMI[8]

Kostot e financimit të sistemit bankar janë ulur më tej gjatë tremujorit të tretë. **Normat e interesit të depozitave** në lekë janë ulur në muajt korrik-gusht. Interesat e depozitave afatgjata (mbi një vit) janë karakterizuar nga luhatje dhe prirje të lehta rritëse muajt e fundit. Në të kundërt, interesat për depozitat 1-12 mujore, të cilat përbëjnë dhe peshën kryesore të depozitave me afat, kanë regjistruar ulje muaj pas muaji. Interesat e depozitave në euro janë shfaqur të luhatshme, por, në terma tremujorë, ato kanë ruajtur të njëjtin nivel nga periudha e mëparshme. Diferenca e tyre me ato të aplikuara nga bankat në Eurozonë, gjithashtu, nuk ka ndryshuar.

Paralelisht me reduktimin e kostos së financimit të sistemit bankar, edhe kostoja e financimit të ekonomisë ka ardhur në rënie. **Normat e interesit të kredisë** në lekë janë shfaqur të luhatshme, por ato kanë konfirmuar prirjen rënëse të vërejtur në muajt e mëparshëm. Interesi mesatar i ponderuar për kredinë e re në lekë rezultoi 7.81% në periudhën korrik-gusht, nga 8.30% në gjysmën e parë të vitit. Ndikimin kryesor në këtë rënie e dha ulja e interesave të kredive

[8] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit gusht 2015.*

Grafik 6. Normat e interesit të depozitave të reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

për investim dhe për kapital qarkullues. Në të njëjtën kohë, edhe interesat për kredi për qëllime konsumi janë ulur, duke mbështetur rritjen e kredisë për këtë kategori. Ulja është udhëhequr nga interesat afatshkurtra dhe afatmesme, ndërsa ato afatgjata, mbi 5 vjet, janë rritur krahasuar me tremujorin e kaluar. Kredia e re vijon të jepet kryesisht për financimin e nevojave të likuiditetit për bizneset dhe mbetet e përqendruar në pak banka.

Interesat për kredinë në euro kanë regjistruar rritje, veçanërisht në muajin gusht. Edhe normat e kredisë së re në euro shfaqen të luhatshme, duke qenë të ekspozuara ndaj normave të aplikuara nga banka të caktuara dhe peshës së tyre në totalin e lëvruar. Interesi mesatar i kredisë në euro llogaritet 6.20% në këtë periudhë, nga 5.97% në tremujorin e mëparshëm. Kjo rritje i dedikohet kryesisht efektit të një banke, ndërkohë që përjashtimi i saj nga analiza paraqet një ecuri më të qëndrueshme të normave të interesit. Marzhet e interesit të kredisë në euro ndaj interesit euribor, kanë qëndruar afërsisht në të njëjtin nivel këto muaj.

Grafik 7. Normat e interesit për kredinë e re



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues, bankat presin të aplikojnë norma më të ulëta interesi në tremujorin e katërt, si për kredinë në lekë, ashtu dhe për atë në euro, duke ndihmuar në lehtësimin e kushteve të financimit.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: REZULTATET E VROJTIMIT TË AKTIVITETIT KREDITUES, TREMUJORI I TRETË 2015

Standardet e kredisë dhënë bizneseve mbetën të pandryshuara, ndërsa ato për individë vijuan prirjen lehtësuese gjatë tremujorit të tretë. Për bizneset, standardet ngelën të pandryshuara, si për kredinë për financim të kapitalit qarkullues, ashtu edhe për kredinë për financim të investimeve. Për individët, standardet u lehtësuan si për kredinë konsumatore, ashtu edhe për kredinë për blerje banese.

Për tremujorin e katërt, bankat vijojnë të jenë më optimiste për kredinë dhënë individëve. Kështu, ato presin lehtësim të standardeve, si për kredinë për blerje banese, ashtu edhe për kredinë konsumatore dhe rritje të kërkesës. Për bizneset, bankat presin lehtësim të standardeve, por në shkallë më të ulët sesa pritjet për kredinë e individëve. Bankat presin rritje të kërkesës nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por rënie të saj nga ndërmarrjet e mëdha.

Ndikimi i faktorëve të ndryshëm në standardet e kreditimit ishte i ngjashëm me një tremujor më parë. Faktorët kryesorë me ndikim në lehtësim janë vendimet e Bankës së Shqipërisë dhe niveli i konkurrencës. Në të kundërt, gjendja e kredive me probleme, situata makroekonomike dhe gjendja financiare e individëve, kanë vijuar të ndikojnë në kahun shtrëngues standardet e kreditimit.

Grafik 8. Ecuria e standardeve dhe e kërkesës së bizneseve për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kriteri kryesor me të cilin bankat zbatuan një politikë lehtësuese, si për bizneset, ashtu edhe për individët, ishte ngushtimi i marzhit mesatar të kredisë. Të gjitha kushtet me të cilat janë akorduar kreditë për individë në tremujorin e tretë, kanë kontribuar në zbatimin e një politike lehtësuese kreditimi. Për bizneset, në kahun shtrëngues së standardeve, ndikuan zgjerimi i marzhit për kreditë me rrezik dhe ulja e maturitetit.

Grafik 9. Ecuria e standardeve dhe e kërkesës së individëve për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e bizneseve për kredi vijoi prirjen rënëse, ndërsa kërkesa e individëve shënoi ritme më të ulëta rritëse në tremujorin e tretë. Kjo e fundit ka shënuar zhvillime pozitive gjatë dy viteve të fundit.

3.3. KREDITIMI I EKONOMISË

Zhvillimet e tremujorit të tretë të vitit evidentojnë një ecuri të dobët të kreditimit për muajt korrik e gusht, ku portofoli i kredisë mbeti i pandryshuar nga niveli i muajit qershor. Ecuria e kredisë në muajt e verës është përgjithësisht e ngadaltë, por dobësia e kredisë e vënë re gjatë kësaj periudhe shkon përtej efektit sezonal. Kjo ecuri duket të jetë ndikuar si nga kërkesa e dobët e bizneseve për financim, ashtu edhe nga kushtet e shtrënguara të ofertës. Shfrytëzimi jo i plotë i kapaciteteve prodhuese redukton kërkesën për investime, ndërkohë që përdorimi i burimeve alternative të financimit, dhe kryesisht i fondeve të vetë biznesit[9], redukton më tej kërkesën për kredi. Nga ana e ofertës, rreziku i lartë i kredisë dhe pasiguria për të ardhmen mbeten faktorë frenues në politikat e kreditimit të bankave.

Analiza e mëposhtme e portofolit të kredisë do të bazohet në të dhënat monetare të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci. Norma vjetore e rritjes së kredisë për sektorin privat u ngadalësua në nivelin 0.7% në muajin gusht, kundrejt vlerës 2.4% të regjistruar në muajin qershor. Ky ngadalësim ka reflektuar plotësisht reduktimin e portofolit të kredisë së bizneseve. Ecuria e qëndrueshme pozitive e kreditimit të individëve ka vijuar edhe gjatë kësaj periudhe, e nxitur nga kërkesa më e lartë për financim dhe nga ofertat e shumta të bankave për këtë segment.

[9] *Sipas të dhënave monetare, përgjatë vitit 2015, depozitat e bizneseve janë mesatarisht 25 miliardë lekë më të larta se niveli mesatar për periudhën 2009-2013. Kjo ecuri mendohet se ka reflektuar edhe shlyerjet e detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj bizneseve.*

HAPËSIRË INFORMUESE 2: PROCESI I PASTRIMIT TË BILANCIT TË BANKAVE

Portofoli i kredisë gjatë vitit 2015, është ndikuar nga procesi i nxjerrjes jashtë bilancit të kredive të humbura për 3 ose më shumë vjet, në zbatim të rregullores së Bankës së Shqipërisë, që hyri në fuqi në janar të këtij viti. Këto kredi kanë ndikuar në reduktimin e vlerës së portofolit të kredisë së bankave në bilanc. Deri në muajin gusht, reduktimi i portofolit të kredisë nga ky proces vlerësohet në rreth 13 miliardë lekë. Sipas të dhënave të publikuara, kredia ndaj sektorit privat në muajin gusht 2015, është me rënie më të ndjeshme nga tabloja e paraqitur në analizë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur të dhënat e publikuara dhe ato të analizuara, të cilat përjashtojnë efektin e kredive të nxjerra nga bilanci i bankave.*

Tabelë 1. Ndryshimet vjetore të kredisë sipas agjentëve ekonomikë, monedhës dhe qëllimit (në %)

Statistika monetare të rregulluara	Kredia e sektorit privat	Lekë	Valutë	Biznese	Individë	Kredi për likuiditete	Kredi për investime	Kredi për konsum	Kredi për banesa
2014	2.0%	6.0%	-0.4%	2.4%	1.2%	1.5%	3.2%	6.5%	-0.2%
2015 T1	2.5%	6.8%	-0.2%	1.9%	4.0%	1.8%	1.9%	6.3%	1.3%
2015 T2	2.4%	6.4%	-0.1%	1.6%	4.3%	0.8%	2.4%	8.0%	2.3%
2015 M7	2.3%	5.9%	-0.1%	1.1%	5.0%	-1.7%	3.9%	10.7%	2.2%
2015 M8	0.7%	5.2%	-2.2%	-1.1%	5.2%	-3.1%	0.8%	11.6%	2.1%

Statistika monetare të publikuara	Kredia e sektorit privat	Lekë	Valutë	Biznese	Individë	Kredi për likuiditete	Kredi për investime	Kredi për konsum	Kredi për banesa
2014	2.0%	6.0%	-0.4%	2.4%	1.2%	1.5%	3.2%	6.5%	-0.2%
2015 T1	1.9%	6.2%	-0.7%	1.3%	3.6%	1.6%	1.0%	5.9%	0.8%
2015 T2	0.3%	5.3%	-2.9%	-0.6%	2.5%	-0.8%	-0.4%	6.3%	0.4%
2015 M7	-0.2%	4.6%	-3.3%	-1.5%	2.9%	-3.7%	0.8%	8.4%	0.1%
2015 M8	-1.7%	3.9%	-5.3%	-3.7%	3.1%	-5.1%	-2.2%	9.2%	0.0%

Procesi i fshirjes ka prekur në nivele të ndryshme portofolin e kredisë sipas agjentëve ekonomikë apo qëllimit të përdorimit. Fshirjet më të mëdha për vitin 2015 janë në portofolin e kredisë për biznese. Prandaj, në statistikat monetare reduktimi vjetor i portofolit të kredisë së bizneseve është ndjeshëm më i lartë se ai i analizuar. Ndërkohë, dinamika pozitive e portofolit të kredisë për individë ka fshehur efektin negativ të nxjerrjeve të kredive nga bilanci. E parë sipas monedhave, vihet re se fshirjet kanë prekur më së shumti kredinë në valutë, kryesisht atë në euro. Sipas statistikave monetare, tkurrja e portofolit të kredisë në valutë është dukshëm më e përkeqësuar nga niveli i analizuar. Ndërkohë, ritmet pozitive të kredisë në lekë kanë fshehur deri diku efektin negativ që ka pasur ky proces. Sipas qëllimit të përdorimit, fshirja e kredisë duket se ka prekur më së shumti kredinë për investime dhe më pak, atë për qëllime likuiditeti. Në kredinë e individëve, kredia hipotekare duket të ketë pasur fshirjet më të larta, kurse kredia konsumatore është prekur më pak nga të gjitha portofolet.

Në përfundim, do të nënvizonim se për qëllim të vendimmarrjes së politikës monetare, analiza e kredisë në raportin aktual dhe në ato që do të vijnë, do të përjashtojë kreditë e nxjerra jashtë bilancit, sepse këto kredi mbeten mjete monetare në përdorim nga agjentët ekonomikë. Gjithashtu, rregullimi i të dhënave për kreditë e nxjerra nga bilanci ndihmon për të kuptuar zhvillimet reale në aktivitetin kreditues.

** Në zbatim të rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë.*

Grafik 10. Kredia sipas agjentëve ekonomikë dhe monedhës*



*Analiza e kredisë bazohet në të dhënat monetare të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci i bankave. Rregullimi i të dhënave është bërë bazuar në raportimet e bankave për këto kredi si dhe bazuar në të dhënat mikro të Regjistrit të Kredisë.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i kredisë për sektorin privat është mbështetur nga rritja e kreditimit në lekë. Rritja vjetore e këtij portofoli shënoi vlerën 5.2% në muajin gusht, ndërkohë që portofoli i kredisë në valutë u tkurr me 2.2%, krahasuar me një vit më parë. Ulja e diferencës së normave të interesit të kredisë midis lekut dhe euros, si dhe perceptimi dhe çmimi më i drejtë i rrezikut të kursit të këmbimit, kanë nxitur zhvendosjen e kërkesës për financim drejt monedhës vendase. Gjithashtu, kjo zhvendosje është përkrahur edhe nga përqendrimi i kërkesës në segmentin e kredisë konsumatore, e cila është kryesisht në lekë. Në fund të muajit gusht, raporti i kredisë në lekë ndaj totalit arriti në 40.8% ose 1.3 pikë përqindjeje më e lartë se në dhjetor 2014.

Ecuria e dobët e aktivitetit kreditues ka reflektuar kërkesën e ulët të bizneseve për kredi, kushtet ende të shtrënguara të kreditimit për këtë segment, por edhe likuiditetin e gjeneruar nga pagimi i faturave të prapambetura. Ndryshimi vjetor i portofolit të kredisë për bizneset shënoi -1.1%, përkundrejt rritjes me 1.6% në muajin qershor. Kjo ecuri është ndikuar nga një performancë e dobët e kredisë për likuiditete, e cila shënoi një tkurrje vjetore prej 3.1% (+0.8% në qershor). Ndërkohë, kredia për investime ka shfaqur ngadalësim të normës vjetore të rritjes në 0.8% (2.4% në qershor). Pagesa e detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj bizneseve në dy vitet e fundit ka injektuar likuiditet tek bizneset, dhe për pasojë, ka ulur kërkesën e tyre për financim, veçanërisht për kredinë afatshkurtër.

Zgjerimi i portofolit të kredisë për individë është mbështetur nga kredia konsumatore, e cila po rritet me norma vjetore pranë nivelit 11.6% (në muajin gusht). Ndërkohë, ritmet vjetore të kredisë hipotekare kanë qëndruar në nivelin 2.1%. Edhe pse bankat kanë lehtësuar dukshëm kushtet e kreditimit për kredinë hipotekare, kërkesa nga individët për këtë produkt mbetet e brishtë, e ndikuar kryesisht nga pasiguritë, si dhe gatishmëria e ulët e individëve për të marrë përsipër rrezik.

Grafik 11. Kredia sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në të ardhmen e afërt, kërkesa e bizneseve për financim do të vazhdojë të reflektojë nevojat e pakta për të investuar në kushtet e kapaciteteve të lira prodhuese dhe kundërshtinë për të marrë përsipër rrezik. Ndërkohë, politikat ende konservatore të kreditimit do të kushtëzojnë gjithashtu nivelet e ulëta të kreditimit. Financimi i bankave ndaj bizneseve pritet të mbetet selektiv dhe i përqendruar në disa banka. Në një afat më të gjatë, përmirësimi i kushteve financiare në Eurozonë pritet të lehtësojë politikat e kreditimit të bankave; rreziku i perceptuar i kredisë pritet të reduktohet, në përgjigje të programit të masave për reduktimin e kredisë me probleme; dhe përpjekjet për formalizimin e ekonomisë pritet të rritin transparencën e bizneseve dhe eficiencën e shpërndarjes së fondeve në ekonomi. Të tre këto zhvillime pritet të formojnë një bazë më solide për rritjen e kredisë në ekonomi.

*HAPËSIRË INFORMUESE 3: MASAT E MARRA PËR NXITJEN E KREDITIMIT**

Ecuria e aktivitetit kreditues ka vijuar të mbetet e dobët në vitet e fundit. Kjo ecuri është diktuar si nga faktorë të ofertës, ashtu edhe nga ato të kërkesës. Analizat e standardeve të kreditimit të bankave tregojnë se kushtet e kreditimit kanë mbetur përgjithësisht të shtrënguara. Paralelisht me to, kërkesa për kredi nga sektori privat ka qenë e ulët. Këto fenomene kanë qenë të pranishme edhe në vendet e Evropës Qendrore e Juglindore, duke përcaktuar një ecuri të dobët të aktivitetit kreditues. Për të adresuar këto problematika, të gjitha këto vende kanë marrë masa të ndryshme për të siguruar rimëkëmbjen e aktivitetit kreditues. Hapësira informuese në vijim, paraqet një përmbledhje të masave të marra nga Banka e Shqipërisë për nxitjen e kreditimit në vend.

Në vitet e fundit, kërkesa për kredi ka reflektuar ngadalësimin ekonomik, e për pasojë, tkurrjen e investimeve, në kushtet e kapaciteteve të lira prodhuese, të cilat kanë përcaktuar rënien e nevojave për financim. Për adresimin e kërkesës së dobët për kredi, Banka e Shqipërisë ka ulur normën bazë të interesit me 4.25

pikë përqindjeje, përkundrejt nivelit të vitit 2008, me qëllim lehtësimin e kostos së kredisë, si dhe mbështetjen më të mirë për financimin e projekteve me kthim të ulët. Në ndjekje të kësaj politike lehtësuese, interesi i kredisë në lekë është ulur me 4.4 pikë përqindjeje për të njëjtën periudhë. Megjithë uljen e ndjeshme të kostos së kredisë, kërkesa për kredi dhe rritja e saj mbeten të ulëta. Ky fakt ilustron se kërkesa për kredinë, pavarësisht kostos së saj, ndikohet edhe nga faktorë të tjerë si: pasiguria që kanë bizneset për të ardhmen apo dhe përdorimi i fondeve të veta.

Oferta për kredi vlerësohet të jetë e shtrënguar në terma afatgjatë. Shtrëngimi i ofertës nga bankat është i shprehur në rritjen e kërkesave për kolateral, në uljen e maturitetit të kredisë së dhënë, në uljen e sasisë së akorduar për kredi etj. Oferta për kredi e bankave ndikohet nga problemet e likuiditetit, niveli i kapitalit të bankës dhe kostoja e tij, nga politikat e grupeve bankare zotëruese, si dhe nga vetë rreziku i kredisë. Më konkretisht, analizat tona vlerësojnë se këta faktorë për Shqipërinë kanë vepruar si më poshtë:

- *Bankat në vitet e fundit janë karakterizuar nga nivele të mira likuiditeti dhe kapitali, prandaj këta faktorë nuk kanë përbërë kufizime të drejtpërdrejta në kredidhënie.*
- *Shtrenjtimi i kostos së kapitalit në tregjet ndërkombëtare mbas vitit 2008, ka ndikuar në uljen e gatishmërisë së bankave për të dhënë kredi.*
- *Ulja e gatishmërisë së grupeve bankare për të marrë përsipër rrezik u reflektua në shtrëngimin e politikave të grupit. Në veçanti, mbas krizës greke të vitit 2011, vendosja e rregullave të reja nga Autoriteti Bankar Evropian ndikoi në shtrëngimin e mëtejshëm të këtyre politikave, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e ofertës për kreditim në vendet e rajonit.*
- *Rritja e rrezikut të kredisë, sikurse tregohet nga niveli i lartë i raportit të kredive me probleme ndaj totalit, përbën shqetësimin kryesor të bankave. Krahas përkeqësimit të performancës së kredisë, bankat janë ndeshur edhe me vështirësi ligjore në procesin e administrimit të kredive me probleme, sidomos për ekzekutimin e kolateraleve.*

Për të adresuar shtrenjtimin e kostos së kapitalit, në vitin 2013, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash me natyrë kundërciklike. Një nga masat kryesore të kësaj pakete ishte aplikimi i kërkesave më të ulëta për kapital për bankat, të cilat do të rritnin portofolin e kredisë me një normë vjetore nga 4–10%. Në këtë paketë masash u përfshi edhe ndryshimi i trajtimit rregullativ për kreditë e ristrukturuara, si në drejtim të uljes së kostos, ashtu edhe të uljes së periudhës që këto kredi përbënin kosto për bankën. Këto masa janë në fuqi deri në fund të vitit 2015.

Për të adresuar raportin e lartë të kredive me probleme dhe rrezikun e kredisë, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë iniciativash, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, si më poshtë:

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në prill të vitit 2014, u ndryshua trajtimi i borxhit të keq për qëllime tatimore, duke lehtësuar barrën tatimore mbi bankat. Ky ndryshim mundësoi heqjen e pengesave ligjore për fshirjen e kredive me probleme. Në përputhje me këtë ndryshim, Banka e Shqipërisë ndërmori një ndryshim rregullativ, nëpërmjet të cilit, i detyronte bankat të nxirrnin jashtë bilancit kreditë e humbura, kur kishin tre ose më shumë vjet në këtë status. Ky vendim hyri në fuqi në janar të vitit 2015.

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me projektin FinSAC të Bankës Botërore, në maj të vitit 2014, ka ndërmarrë një iniciativë për ristrukturimin e kredimarrësve të mëdhenj. Nëpërmjet kësaj iniciative, është synuar ristrukturimi i kredimarrësve

të mëdhenj në të gjitha bankat ku ato kanë ekspozim, me qëllim koordinimin e përpjekjeve dhe gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

Megjithëse masat e deritanishme kanë dhënë efekt dhe pritet të japin më tej efekt në uljen e raportit të kredive me probleme, kreditë me probleme mbeten në nivele të larta. Për të adresuar më tej këtë problematikë, në korrik të vitit 2015, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim edhe me organe të tjera të qeverisë, kanë hartuar planin kombëtar për uljen e kredive me probleme. Ky plan veprimi është bazuar në ndryshimet ligjore dhe rregullative, të cilat synojnë të zgjidhin si problematikat që lidhen me performancën e kredisë së keqe, ashtu edhe me ekzekutimin e kolateralit. Më konkretisht, ky plan masash përfshin:

- *Ndryshimet ligjore, të cilat do të ndërmerren nga Ministria e Drejtësisë, e Financave, e Ekonomisë dhe institucioneve në varësinë e tyre, janë: hartimi i ligjit të ri të falimentit, ndryshime në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, ndryshime në ligjin për barrët siguruese, si dhe qartësim i ndërveprimit të ligjit "Për procedurat tatimore" me dispozitat e tjera për ekzekutimin e detyrueshëm.*

- *Ndryshime rregullative, të cilat do të ndërmerren nga Banka e Shqipërisë janë: shtyrja e afatit të paketës së masave makroprudenciale për nxitjen e kreditimit; rishikimi i afatit kohor të mbajtjes së pasurive të patundshme të mbledhura nga ekzekutimet e kolateraleve në bilancet e bankave; gjetja e zgjidhjeve për kredimarrësit më të mëdhenj në sistem; përmirësimi i kuadrit rregullativ për shitjen e kredive me probleme; përmirësimi i të dhënave në regjistrin e kredive, si dhe mbështetja e analizave financiare për dhënien e kredive mbi deklaratat tatimore, duke filluar nga viti 2018.*

Paketa e masave pritet të ndikojë në zbutjen e rrezikut të kredisë dhe të rrisë gatishmërinë e bankave për të marrë përsipër rrezik. Kjo, së bashku me përmirësimin e kushteve të financimit dhe uljen e perceptimit për rrezikun në tregjet në Eurozonë, do të ndikojnë në lehtësimin gradual të ofertës për kredi. Përmirësimi i ofertës dhe i kushteve të kreditimit do të nxisë në mënyrë indirekte edhe kërkesën për kredi, duke mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit kreditues në periudhën afatgjatë.

* *Kjo hapësirë informuese është përgatitur nga Erjona Suljoti, Departamenti i Politikës Monetare dhe Gerond Ziu, Departamenti i Mbikëqyrjes.*

3.4. ECURIA E TREGUESVE MONETARË

Zgjerimi i masës monetare ka pësuar ngadalësim në muajt korrik dhe gusht. Treguesi i parasë së gjerë, agregati M3, shënoi një normë rritjeje vjetore prej 3% në gusht, krahasuar me normën 3.9% të regjistruar në muajin qershor. Krijimi i parasë në ekonomi vijon të mbështetet nga përbërësi valutor, i cili ka dhënë një kontribut vjetor me 7.6 pikë përqindjeje në zgjerimin e M3. Ndërkohë, normat e rritjes së agregatëve monetarë janë frenuar nga ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë dhe kërkesa e ulët e sektorit publik.

Agregati i parasë në lekë, M2, shënoi një ngadalësim të rritjes në 3.8% në muajin gusht, kundrejt normës prej 4.8% në fund të gjysmës së parë të vitit. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 ka shënuar rritje në 31.7% në muajin

gusht, duke reflektuar edhe kërkesën e shtuar sezonale për mjete likuide gjatë muajve të verës. Njëkohësisht, në muajt korrik dhe gusht ka vijuar rritja e investimeve të individëve në letra me vlerë të qeverisë. Duke marrë parasysh këtë zhvendosje, raporti i parasë jashtë bankave ndaj aktiveve financiare në lekë[10] rezulton në 25.9%, duke qenë pranë mesatares së 5 viteve të fundit.

Grafik 12. Ecuria e treguesve monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat në sistemin bankar[11] në fund të muajit gusht rezultojnë rreth 2.6% më të larta se një vit më parë. Ecuria vjetore e depozitave tregon për ngadalësim të normave të rritjes, si për depozitat në lekë (rritje vjetore prej 2.7%), ashtu edhe në valutë (rritje vjetore prej 2.5%). Në terma absolutë, stoku i depozitave në muajt korrik e gusht u zgjerua me rreth 7.4 miliardë lekë, i ndikuar plotësisht

Grafik 13. Zhvillimet në depozita



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[10] *Në llogaritjen e aktiveve financiare në lekë janë përfshirë agregati M2, depozitat në lekë mbi dy vjet, si dhe investimet në lekë në letra me vlerë.*

[11] *Analiza e depozitave përfshin dhe depozitat me afat maturimi mbi dy vjet, të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e parasë së gjerë M3.*

nga zgjerimi i depozitave në valutë. Kjo ecuri ka reflektuar hyrjet sezonale të flukseve valutore gjatë muajve të verës, si dhe rikthimin në sistem të depozitave të tërhequra në muajin qershor, si pasojë e efekteve psikologjike të krizës greke.

Në terma të maturiteteve, depozitat me afat maturimi nën dy vjet kanë vijuar të zhvendosen drejt depozitave pa afat ose drejt depozitave me maturitet mbi dy vjet. Ndërkohë, ecuria e depozitave sipas agjentëve ekonomikë, për muajt korrik e gusht, krahas rritjes së depozitave të individëve tregon për ecuri të mirë të depozitave të bizneseve, e cila krahas prurjes sezonale të aktivitetit të turizmit, lidhet edhe me hyrjet në sistem të pagesave të detyrimeve të prapambetura nga sektori publik.

Në pjesën e mbetur të vitit, oferta e parasë në ekonomi pritet të rritet me norma të ngjashme me ato aktualet. Kreditimi i dobët i ekonomisë, edhe gjatë kësaj periudhe, parashikohet të frenojë zgjerimin e agregatëve monetarë. Normat e ulëta të interesit do të përkrahin zhvendosjen e kursimeve drejt depozitave me afat mbi dy vjet dhe drejt investimeve në letra me vlerë. Zhvillimet e pritura monetare nuk pritet të origjinojnë presione inflacioniste në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Inflacioni mesatar vjetor qëndroi në nivelin 1.8% në tremujorin e tretë, duke shfaqur prirje rritëse gjatë dy muajve të fundit. Presionet e ulëta nga kërkesa janë reflektuar në nivelet e ulëta të inflacionit bazë, ndërsa goditjet nga oferta janë pasqyruar në luhatjet e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara.

Ekonomia shqiptare ka vazhduar rikuperimin me ritme të ngadalta në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 dhe pritjet tona janë për ritme të ngjashme rritjeje edhe për pjesën e mbetur. Rritja ekonomike prej 2.5% e tremujorit të dytë, është mbështetur kryesisht në rritjen e investimeve në ekonomi dhe në përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë. Nga ana tjetër, konsumi privat vijoi tkurrjen, kryesisht në reflektim të forcimit të prirjes së konsumatorëve për kursim. Përmirësimi i rritjes ekonomike gjatë viteve në vazhdim, pritet të mbështetet nga reduktimi i kursimeve të akumuluara të sektorit privat, nga përmirësimi i kushteve të financimit në reflektim të politikës monetare lehtësuese, nga përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë, si dhe nga rritja e kërkesës në tregjet eksportuese. Hendeku negativ i prodhimit parashikohet të mbyllet gradualisht përgjatë vitit 2016, duke kaluar në kahun pozitiv në fillim të vitit 2017.

Në vlerësimin tonë, presionet inflacioniste në afat të shkurtër do të mbeten të ulëta, të kushtëzuara nga hendeku negativ i prodhimit, nga nivelet e ulëta të çmimeve të produkteve bazë dhe të inflacionit në tregjet partnere. Ndikimi i këtyre faktorëve pritet të zbehet dhe inflacioni parashikohet të kthehet në objektivin e Bankës së Shqipërisë në fillim të vitit 2018.

4.1. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

4.1.1. EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore vijon të zgjerohet gradualisht dhe me ritme të ndryshme midis rajoneve. Aktiviteti ekonomik në ekonomitë e zhvilluara po mbështetet nga çmimet e ulëta të naftës, nga kushtet e përmirësuara të financimit, nga përmirësimi i tregjeve të punës dhe nga zbehja e efekteve të lidhura me konsolidimin fiskal. Ndërkohë, ekonomitë në zhvillim po përjetojnë një ngadalësim të rritjes ekonomike dhe rritje të pasigurisë. Ambienti ndërkombëtar po reflekton dobësimin e ritmeve të ekonomisë kineze, duke e faktorizuar atë në parashikime për një rritje më të ulët të ekonomisë botërore. Zbehja e treguesve të kërkesës për lëndë të para dhe atyre të tregtisë botërore, kanë influencuar ecurinë e ekonomive të shteteve në zhvillim. Balancat makroekonomike dhe

problemet strukturore të këtyre shteteve kanë rritur stresin në aktivitetin ekonomik. Presionet inflacioniste vijojnë të jenë të ulëta, si pasojë e ndikimit të rënies së çmimeve të lëndëve energjetike dhe atyre të para.

Tabelë 2. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së				Norma e papunësisë	Norma e inflacionit	
	tremujor		vjetor				
	T1-15	T2-15	T1-15	T2-15	Gusht-15	Shtator15/ Gusht-15	Shtator-15/ Shtator-14
ShBA	0.2	0.9	2.9	2.7	5.1[1]	0.1	0.2
Eurozonë	0.5	0.4	1.2	1.5	11.0	0.2	-0.1
Gjermani	0.3	0.4	1.1	1.6	4.5	-0.3	-0.2
Francë	0.7	0.0	0.9	1.0	10.8	-0.4	0.1
Mbretëri e Bashkuar	0.4	0.7	2.9	2.6	5.4[2]	-0.1	-0.1

Burimi: BQE, FED, Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
[1] Muaji shtator; [2] Intervali qershor-gusht 2015.

Ekonomia e Eurozonës

Ekonomia e Eurozonës shënoi një rritje vjetore prej 1.5% dhe një rritje tremujore prej 0.4% në tremujorin e dytë. Në tremujorin e parë të 2015-ës, këto shifra ishin përkatësisht 1.2% dhe 0.5%. Rritja u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit dhe i eksporteve neto, ndërkohë që ndikimi i investimeve ishte në kahun rënës. Treguesit paraprijës të ecurisë së PBB-së për Eurozonën në dy muajt e fundit, konfirmojnë prirjen pozitive të saj, e cila gjithsesi mbetet e rrethuar nga faktorë pasigurie. Treguesit e besimit të biznesit dhe të konsumatorëve për tremujorin e tretë kanë ecur në drejtime të kundërta. Bizneset kanë treguar pritje pozitive, ndërsa konsumatorët i kanë zbehur ato. Treguesit PMI[12] për prodhimin

Grafik 14. Indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, KE.

[12] *Indekset PMI (indeks i menaxherëve përgjegjës për blerjet) janë tregues ekonomikë të përfituar nga vrojtimi i kryer mbi një grup të madh biznesesh përfaqësues të sektorit prodhues të një shteti. Indeksi përbëhet nga 5 nënndarje (niveli i prodhimit, porosi të reja, punësimi, niveli i magazinës dhe niveli i çmimeve). Vlera mbi 50 të indeksit tregojnë rritje ose zgjerim dhe ato nën 50 të kundërtën. Indeksi PMI përbën një nga treguesit më të shpejtë për ecurinë ekonomike, pasi përgjigjet e përgjegjësve të bizneseve janë të bazuara detyrimisht mbi të dhëna reale dhe jo mbi opinione. Prodhuesit kryesorë të këtij indeksi janë "Markit Group", i cili kryen vrojtime në mbi 30 shtete dhe "ISM" në ShBA.*

në Eurozonë, sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë me të njëjtat ritme si në atë paraardhës. Ndërkohë, parashikimet e publikuara së fundi kanë rishikuar për poshtë PBB-në për vitet 2015 dhe 2016[13]. Parashikimet kanë reflektuar të dhënat e fundit jopozitive të disa ekonomive në zhvillim. Inflacioni në muajt e fundit u rikthye në terren negativ (shtator -0.1%) dhe pritjet për muajt në vijim u rishikuan për poshtë, nisur nga çmimet e ulëta të naftës dhe të lëndëve të para.

Ekonomia e SHBA-së

Ekonomia e ShBA-së ka vijuar të zgjerohet edhe në tremujorin e dytë të vitit 2015, duke treguar vlera të larta të rritjes vjetore. Ky zhvillim është mbështetur kryesisht tek rritja e shpenzimeve konsumatore, e investimeve jorezidenciale, e shpenzimeve të qeverive lokale dhe e eksporteve. Rritja e importeve dhe ngadalësimi i shpenzimeve të qeverisë federale kanë tërhequr në kahun e kundërt rritjen ekonomike. Papunësia ka vijuar të qëndrojë në nivele të ulëta, ndërsa inflacioni është lehtësisht pozitiv. Të dhënat me frekuencë më të lartë sugjerojnë për një rritje të qëndrueshme edhe në gjysmën e dytë të vitit. Mjedisi ekonomik në vend mendohet të diktojë një rritje të mundshme të normës së interesit nga Rezerva Federale brenda fundit të vitit.

Ekonomitë e rajonit

Ekonomia italiane ka shënuar një rritje pozitive në tremujorin e dytë të vitit, duke përshpejtuar ritmin e rritjes. Rritja është mbështetur nga shpenzimet konsumatore dhe investimet publike e private. Rritja e importeve ka tejkaluar atë të eksporteve, duke ushtruar presion për ngadalësimin e aktivitetit ekonomik. Të dhënat me frekuencë më të shpejtë, si prodhimi industrial dhe indekset e besimit sugjerojnë për një rritje ekonomike pozitive edhe në tremujorin e tretë të vitit.

Ekonomia e Greqisë ka treguar një rritje ekonomike pozitive në tremujorin e dytë. Baza e ulët krahasuese ka bërë që të kemi një rritje të shpenzimeve konsumatore e qeveritare, të cilat janë shoqëruar me tkurrjen e shpejtë të importeve dhe kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike vjetore. Investimet janë tkurrur me terma të shpejtë. Situata e brishtë politike dhe negociatat për ristrukturimin e borxhit që ndaluan aktivitetin bankar për një periudhë të gjatë në tremujorin e tretë, pritet të kenë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ekonomia turke ka konsoliduar rritjen ekonomike në tremujorin e dytë të vitit. Rritja është ushqyer nga rritja e shpenzimeve konsumatore, investimeve private dhe e shpenzimeve qeveritare. Ndryshimet në inventarë, tkurrja e eksporteve dhe rritja e importeve, kanë ushtruar efektin e tyre në ngadalësimin e rritjes ekonomike. Të dhënat e tërthorta tregojnë për një rritje pozitive më të moderuar në tremujorin e tretë të vitit.

[13] *ECB staff macroeconomic projection, shtator 2015.*

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit

Vendet	Ndryshimi i PBB-së T2:15/T2:14	Inflacioni vjetor Shtator-15	Norma e papunësisë Gusht -15
Itali	0.7	0.2	11.9
Greqi	1.6	-0.8	24.6[1]
Maqedoni	2.6	-0.2	26.8[1]
Serbi	1.0	1.4	17.9[1]
Kroaci	1.4	-0.5	15.5
Turqi	3.8	8.0	9.8[3]
Kosovë	0.2[2]	-1.2	35.3[4]
Shqipëri	2.5	2.2	17.3[1]

1- Vlera për T2 2015; 2- Vlera për T1 2015; 3- Vlera për muajin korrik 2015; 4- Vlera për vitin 2014.

Ekonomia e Maqedonisë ngadalësoi disi ritmin e rritjes në tremujorin e dytë të vitit. Ngadalësimi ka ardhur si pasojë e tkurrjes në terma vjetorë të investimeve private. Rritja ekonomike është mbështetur nga ecuria e shpenzimeve konsumatore, e investimeve dhe shpenzimeve publike, si dhe kontributi në rritje i eksporteve neto. Të dhënat nga prodhimi industrial tregojnë për një ngadalësim të lehtë në tremujorin e tretë të vitit.

Ekonomia e Kosovës ka ngadalësuar ritmin e rritjes në tremujorin e parë të vitit, pas një rritjeje të shpejtë në vitin e mëparshëm. Shpenzimet konsumatore janë rritur në terma pozitivë, ndërsa ato qeveritare janë tkurrur. Rritja e shpejtë e eksporteve ka eklipsuar rritjen e importeve. Të dhënat e tërthorta tregojnë për ecuri të dobët të prodhimit industrial dhe një përmirësim të shfrytëzimit të minierave gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Ecuria e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet botërore

Tregjet e mallrave kryesore janë karakterizuar nga një rënie e çmimeve edhe në tremujorin e tretë. Çmimet e energjisë dhe të metaleve shënuan rënien më të ndjeshme, si rrjedhojë e rënies së kërkesës në Kinë.

Grafik 15. Ndryshimet vjetore të çmimeve bazë



Burimi: EIA, FMN dhe INSTAT.

Mbështetur në indeksin evropian Brent, çmimi i naftës në tregjet botërore arriti mesatarisht 50$/fuçi, duke u përgjysmuar në krahasim me një vit më parë. Kjo ecuri u diktua kryesisht nga teprica e ofertës në treg dhe nga ngadalësimi i ekonomisë në Kinë. I njëjti trend gjeti pasqyrim edhe në tregun vendas, ku çmimi i naftës shfaqi rënie, veçanërisht në periudhën gusht-shtator. Çmimi i naftës për fuçi në vitin 2016 nuk pritet të kalojë nivelin e 60$, ndërkohë që investimet në këtë sektor në ShBA janë frenuar.

Në terma vjetorë, indeksi i FMN-së për çmimet e ushqimeve humbi rreth 16.3% të vlerës së tij gjatë këtij tremujori. Mungesa e presioneve nga ana e ofertës, si dhe forcimi i dollarit amerikan diktuan kahun rënës të këtij treguesi. Nën trysninë e zhvillimeve ekonomike në Kinë dhe dobësimit të kërkesës, çmimet e metaleve u tkurrën me 27.0% në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 16. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BoJ dhe BoE).

4.1.2. TREGJET FINANCIARE BOTËRORE

Bankat qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit, përkatësisht në 0.05% BQE, në 0.15% Rezerva Federale, në 0.5% Banka e Anglisë dhe në 0-0.1% Banka e Japonisë.

Në tregjet e parasë së Eurozonës, normat euribor vijojnë të ulen, duke reflektuar politikën lehtësuese të likuiditetit të BQE-së. Normat libor për dollarin amerikan kanë ruajtur të njëjtin nivel me tremujorin e kaluar. Në tregjet e kapitaleve, *yield*-et e obligacioneve kanë shfaqur ecuri rënëse të ndikuara nga pritjet e agjentëve mbi zhvillimet ekonomike. Këto të fundit kanë shtyrë në kohë kthimin e kahut të politikës monetare të bankave qendrore kryesore. Me

Grafik 17. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

përjashtim të dy intervaleve, në fillim të muajit korrik dhe në mes të muajit gusht të lidhura përkatësisht me arritjen e marrëveshjes me Greqinë dhe zhvillimet në Kinë, ecuria e *yield*-eve ka qenë në kahun rënës.

Në tregun valutor, euroja është mbiçmuar ndaj dollarit amerikan dhe ndaj shumë monedhave kryesore në tremujorin e tretë. Analiza e ecurisë së monedhës evropiane ndaj dollarit amerikan tregon se ajo po rikuperon nënçmimin e ndodhur prej fillimit të politikës për lehtësim sasior nga BQE-ja në janar të këtij viti. Në terma mesatarë bilateralë, një euro u këmbye me 1.1221 dollarë amerikanë në muajin shtator, duke u mbiçmuar 2.0%, krahasuar me muajin korrik. Në terma tremujorë, euroja u mbiçmua 0.6% ndaj monedhës së gjelbër.

4.2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare shënoi një rritje vjetore prej 2.5% në tremujorin e dytë të vitit 2015. Kjo normë rritjeje ishte në kahun e poshtëm të pritjeve tona. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik vazhdoi të mbështetej nga rritja e investimeve dhe nga përmirësimi i vazhduar i bilancit të shkëmbimeve me jashtë, ndërkohë që rënia e konsumit privat dhe sektori bujqësor ndikuan negativisht normat e rritjes.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e tretë tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes. Rritja ekonomike në gjashtëmujorin e dytë pritet të ruajë ritme dhe profil të ngjashëm me atë në gjysmën e parë të vitit. Informacioni i ri lë të pandryshuar parashikimin për një rritje më të lartë se vitin e kaluar, por ka zhvendosur për poshtë balancën e rreziqeve rreth tij.

Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 2.5% dhe 0.2%, përkatësisht në nivel vjetor e tremujor[14]. Këto norma rritjeje shfaqin një ngadalësim të lehtë, kundrejt vlerave të regjistruara në tremujorin e parë. Sektori i ndërtimit prodhoi rreth 78% të rritjes ekonomike, ndërkohë rritja e sektorit të shërbimeve u ngadalësua dhe prodhimi bujqësor shënoi rënie. Nga këndvështrimi i kërkesës, investimet dhe eksportet neto ishin kontribuesit kryesorë në zgjerimin ekonomik. Kërkesa e brendshme nuk gjeti mbështetje nga konsumi privat, i cili u tkurr për të tretin tremujor radhazi. Në rënien e shpenzimeve konsumatore vlerësohet të ketë ndikuar prirja e shtuar drejt kursimit, në kushtet e rritjes së pasigurisë[15]. Rritja e kërkesës së huaj për shërbimet shqiptare dhe rënia e importit të tyre ka rezultuar në ngushtimin e deficitit të eksporteve reale neto. Kontributi i këtij komponenti në rritjen e aktivitetit ekonomik ishte pozitiv. Komponenti tjetër i kërkesës së brendshme, konsumi i administratës publike llogaritet të mos ketë kontribuar në rritjen e ekonomisë në këtë tremujor.

[14] *Në datën 5 tetor të vitit 2015, INSTAT-i publikoi të dhënat e produktit të brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe komponentët e kërkesës agregate deri në tremujorin e dytë të vitit 2015. Të dhënat e vitit 2013 janë gjysmë përfundimtare, ato për vitin 2014 paraprake dhe të dhënat për vitin 2015 një publikim i parë, duke qenë subjekt rishikimi në të ardhmen.*

[15] *Për më shumë, shih hapësirën informuese 5 "Matja e pasigurisë ekonomike dhe lidhja me konsumin dhe investimet".*

Grafik 18. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e tretë të vitit tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes.[16] Në ngjashmëri me gjashtëmujorin e parë, rritja e ekonomisë për pjesën e mbetur të vitit pritet të gjejë mbështetje kryesore tek kërkesa e brendshme, e udhëhequr nga investimet. Nga ana tjetër, kërkesa e brishtë në Eurozonë, si dhe niveli i ulët i çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar, pritet të vazhdojnë të jenë faktorë frenues për rritjen e eksporteve shqiptare.

Në vlerësimet tona të kaluara, aplikimi i masave shtrënguese në Greqi pritej të reduktonte rritjen ekonomike në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Zgjedhjet e parakohshme në Greqi e kanë shtyrë kohën e aplikimit të këtyre masave. Ndërsa vlerësimet tona mbeten të vlefshme, periudha e efektit të tyre është shtyrë, në përputhje me fillimin e zbatimit të tyre. Gjithashtu, duke faktuar ecurinë e deritanishme të eksporteve drejt Greqisë, kanali kryesor i përcjelljes vlerësohet të jetë nëpërmjet remitancave i zgjatur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.

Balanca e rreziqeve rreth këtij vlerësimi qëndron në kahun e poshtëm. Ato reflektojnë pasiguritë për zhvillimet e ardhshme ekonomike e financiare në Eurozonë dhe brenda vendit.

4.2.1. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE

PBB-ja reale u rrit me 2.5% në tremujorin e dytë të vitit 2015, nga 2.8% në tremujorin e mëparshëm. Edhe gjatë tremujorit të dytë kontributin më të lartë në rritjen ekonomike e dha sektori prodhues, me 2.5 pikë përqindjeje. Aktiviteti në këtë sektor u ndikua në masën më të madhe, nga rritja e vlerës së shtuar në aktivitetin ndërtues, rreth 2.0 pikë përqindjeje. Aktivitetet industriale kontribuan me 0.7 pikë përqindjeje në rritjen e PBB-së, ndërsa vlera e shtuar nga bujqësia, pyjet dhe peshkimi shënoi rënie vjetore me 0.8%[17], duke ulur me 0.2 pikë përqindjeje kontributin e sektorit prodhues për ekonominë. Ndërkohë, sektori i shërbimeve vijoi të ngadalësohet për të tretin tremujor radhazi, duke dhënë një kontribut me 0.7 pikë përqindjeje në normën e rritjes së PBB-së. Për sa i takon komponentit të taksave neto mbi produktet[18], kontributi i tyre në rritjen vjetore të PBB-së llogaritet negativ, rreth 0.7 pikë përqindjeje.

[16] *Analiza ekonomike dhe vlerësimet e kërkesës agregate për tremujorin e tretë mbështeten mbi treguesit e përditësuar fiskalë, të tregtisë së jashtme, të kredisë dhe të depozitave deri në muajin gusht dhe të treguesve të besimit për tremujorin e tretë të vitit 2015.*

[17] *Të dhënat e vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit tregojnë për rritje të lehtë të sektorit me 0.3% në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, duke mos pasqyruar ende rezultatet pozitive nga përmirësimi i infrastrukturës bujqësore, mbështetja më e mirë financiare nga sistemi bankar dhe politikat lehtësuese të qeverisë.*

[18] *Seria e taksave neto llogaritet si diferenca e taksave mbi produktet me subvencionet mbi produktet.*

Grafik 19. Prodhimi i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Vlera e shtuar nga sektori industrial u zgjerua me 6.3% në tremujorin e dytë, një normë kjo lehtësisht më e ulët se rritja vjetore me 7.1% e tremujorit të parë. Performanca e përmirësuar e degës së industrisë përpunuese, u përkthye në një kontribut prej 3.0 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të sektorit. Industritë e tjera që grupojnë vlerën e shtuar nga "Industritë nxjerrëse, energjia, uji dhe trajtimi i mbetjeve" ngadalësuan rritjen vjetore në 5.6%, nga 9.1% në tremujorin e mëparshëm. Të dhënat e indeksit të vëllimit të prodhimit dëshmojnë për vijim të tkurrjes në prodhimin e realizuar nga industria nxjerrëse dhe dinamika pozitive për degët "Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" dhe "Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve"[19]. Nivelet më të

Grafik 20. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[19] *Në tremujorin e dytë të vitit 2015, indeksi i prodhimit për industrinë nxjerrëse regjistroi rënie vjetore me 18.9%, pas kontraktimit me 26.3% në tremujorin e parë. Ndërkohë, prodhimi i degëve "Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar" dhe "Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve" rezultoi më i ngadalësuar, duke regjistruar rritje me përkatësisht 10.2% dhe 20.2%.*

ulëta të treguesit të besimit të bizneseve në industri dhe të normës së shfrytëzimit të kapaciteteve sugjerojnë për tendenca ngadalësuese në sektorin e industrisë në tremujorin e tretë.

Sektori i ndërtimit gjallëroi ndjeshëm performancën në tremujorin e dytë të vitit 2015. Vlera e shtuar e sektorit u zgjerua me 24.5%, duke thelluar tendencën përmirësuese të ecurisë vjetore. Kjo dinamikë u pasqyrua edhe nga rritjet më të larta të shifrës së afarizmit në vëllim, me 11.8%, dhe të indeksit të vëllimit të prodhimit në ndërtim, me 22.7% në terma vjetorë. Duke gjykuar nga të dhënat e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit[20], ecuria e mirë e sektorit ka reflektuar kryesisht shtimin e ndërtimeve të reja jorezidenciale dhe të rikonstruksioneve[21], të nxitura si nga sektori privat dhe nga ai publik[22]. Treguesit e vrojtimeve[23] japin sinjale pozitive lidhur me zhvillimet e pritura në sektorin e ndërtimit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015.

Grafik 21. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[20] *Të dhënat e lejeve të ndërtimit dhe të llojeve të ndërtimeve publikohen në buletinet statistikore tremujore të INSTAT-it.*

[21] *Në tremujorin e dytë të vitit 2015, vlera e lejeve të ndërtimit paraqet rritje më të larta vjetore të ndërtimeve të reja, kryesisht, për ndërtesa të lidhura me aktivitetin industrial dhe atë tregtar, si edhe të punimeve inxhinierike të lidhura me linjat e ujësjellësve, elektrike dhe ato të telekomunikacionit, si edhe për kategorinë e punimeve në rrugë dhe autostrada.*

[22] *Rreth 54% e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit për tremujorin e dytë i atribuohet klientëve privatë, ndërsa 46% i takon klientit publik. Gjithashtu, realizimi i projekteve infrastrukturore të mbështetura nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve sugjeron për vazhdim të investimeve publike.*

[23] *Në tremujorin e tretë, bizneset në sektorin e ndërtimit vlerësojnë në rritje kërkesën dhe prodhimin, ashtu si edhe normën e shfrytëzimit të kapaciteteve. Megjithatë, duhet theksuar se ecuria e treguesve mbetet nën mesataret përkatëse historike.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4: ECURIA E ÇMIMEVE NË TREGUN E BANESAVE[24]

Indeksi i çmimit të banesave u rrit 5.4% vit mbi vit në tremujorin e tretë, pas rritjes me 2.3% një tremujor më parë. Indeksi i qirasë së banesave u rrit me 7.7% në këtë tremujor. Luhatjet e ngjashme afatshkurtra të indekseve kanë ndikuar në ruajtjen e një niveli të qëndrueshëm të raportit të tyre gjatë pesë viteve të fundit.

Grafik 22. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në çmimet e tregut të pasurisë së paluajtshme gjatë tremujorit të tretë janë karakterizuar nga gjallërimi i kërkesës dhe nga rikuperimi i ofertës për banesa. Bazuar në vrojtimin e besimit të ndërtimit, kërkesa në ndërtim ka regjistruar përmirësim. E njëjta prirje konfirmohet edhe nga vrojtimi i aktivitetit kreditues, sipas të cilit bankat raportojnë rritje të kërkesës së individëve për kredi hipotekare (megjithëse më e ulët se në tremujorin e dytë të vitit).

Çmimet në prodhim të matura nëpërmjet vrojtimit të biznesit raportohen me ulje të lehtë në tremujorin e tretë dhe gjendja e inventarëve në një prirje të lehtë rënëse.

Grafik 23. Tregues nga vrojtimi i besimit të ndërtimit (majtas) dhe nga vrojtimi i aktivitetit kreditues (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[24] *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacion mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*

Aktiviteti i sektorit të shërbimeve ndoqi tendencën ngadalësuese të nisur në tremujorin e katërt të vitit 2014. Vlera e shtuar në ekonomi nga shërbimet u rrit me 1.7% në tremujorin e dytë, një normë vjetore kjo më e ulët se zgjerimi vjetor prej 2.6% i tremujorit të parë të këtij viti dhe se norma historike e rritjes vjetore prej 2.7%. Frenimi i ritmeve të rritjes u përcaktua kryesisht nga tkurrja e vlerës së shtuar në shërbimet e lidhura me aktivitetet profesionale dhe shërbimet administrative[25]. Ndërkohë, rreth 1.0 pikë përqindjeje në rritjen e sektorit është formuar nga aktiviteti në degën e administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë. Degët e "Tregtisë, hoteleve e restoranteve e transportit"[26] dhe të "Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit" e rritën vlerën e shtuar të shërbimeve përkatësisht me 0.4 dhe 0.3 pikë përqindjeje. Ecuria e përmirësuar e të dhënave të vrojtimeve për treguesit e besimit, kryesisht në aktivitetin tregtar dhe për normat e shfrytëzimit të kapaciteteve, sugjeron për dinamikë pozitive të sektorit në tremujorin e tretë.

Grafik 24. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

4.2.2. KËRKESA AGREGATE

Rritja e kërkesës agregate në tremujorin e dytë është formuar nga kontributi pozitiv i formimit bruto të kapitalit fiks dhe i kërkesës së huaj neto. Shpenzimet private dhe publike për mallra dhe shërbime kanë vijuar të japin kontribut negativ në formimin e kërkesës agregate.

[25] *Sipas Klasifikimit Shqiptar të Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev. 2), në këtë degë grupohen shërbimet e "Aktiviteteve profesionale, shkencore dhe teknike" (seksioni M) dhe "Shërbimet administrative e mbështetëse" (seksioni N). Të dhënat e statistikave afatshkurtra sugjerojnë ngadalësim të ritmeve të rritjes së shifrës së afarizmit në vëllim për shërbimet e ofruara nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe të tjera shërbime udhëtimi, pjesë e seksionit N, në tremujorin e dytë.*

[26] *Duke iu referuar të dhënave të shifrës së afarizmit në vëllim, aktivitetet e hotelerisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore, krahasuar me ecurinë e aktivitetit të realizuar në degët e tregtisë dhe të transportit e magazinimit. Më konkretisht, shifra e afarizmit të hoteleve shënoi një rritje vjetore prej 14.0% në tremujorin e dytë, pas rënies vjetore prej 3.2% në tremujorin e parë.*

Për sa i përket tremujorit të tretë, të dhënat sasiore indirekte dhe vrojtimet e besimit sugjerojnë se kërkesa agregate do të rritet, e ndikuar njëkohësisht nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare dhe nga kërkesa e brendshme. Kjo e fundit pritet të mbështetet kryesisht në zgjerimin e vazhduar të investimeve, ndërkohë që ecuria e konsumit privat pritet të mbetet e dobët.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me të njëjtin ritëm si një tremujor më parë, 1.1%. Rritja e kërkesës së brendshme u ndikua pozitivisht nga rritja e komponentit të formimit bruto të kapitalit fiks, por ky kontribut u zbeh nga tkurrja e mëtejshme e konsumit final privat dhe publik në këtë tremujor.

Tregues të tjerë ekonomikë që disponohen më shpejt se llogaritë kombëtare, si dhe të dhënat e vrojtimeve të besimit, sugjerojnë për rritje të ngadaltë të kërkesës së brendshme në tremujorin e tretë të vitit. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) pësoi rënie me 2.7 pikë në tremujorin e tretë, por ai vazhdon të qëndrojë mbi mesataren afatgjatë. Ky tregues është karakterizuar nga një luhatshmëri më e lartë gjatë katër tremujorëve të fundit.

Grafik 25. Struktura e kërkesës së brendshme (kontribute në ndryshimin vjetor të saj) dhe treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatare afatgjatë=100)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat ra me 3.2% në tremujorin e dytë, duke kontribuar negativisht në kërkesën agregate për të tretin tremujor radhazi. Analiza e treguesve të konsumit bazuar në tregues sasiorë indirektë, tregon për vijim të prirjes rënëse të shpenzimeve për mallra të qëndrueshme në tremujorin e dytë[27]. Indeksi i tregtisë me pakicë për mallrat afatgjata dhe importi i autoveturave regjistruan rënie vjetore këtë tremujor[28]. Ndërkohë, rritja e shpenzimeve të konsumatorëve

[27] *Teorikisht, në periudha të karakterizuara nga rritje e nivelit të pasigurisë, individët ulin më shumë shpenzimet për mallra afatgjata, si për shembull pajisje elektroshtëpiake, mobilje, autovetura etj.*

[28] *Indeksi i nëngrupit të tregtisë me pakicë "Pajisje të ndryshme elektroshtëpiake, mobilje dhe pajisje të tjera shtëpiake" regjistroi rënie vjetore prej 4.1% dhe importi i autoveturave të pasagjerëve shënoi rënie vjetore prej 15.4% në tremujorin e dytë.*

për mallra afatshkurtra dhe për shërbime ka qenë më e ulët se një tremujor më parë[29].

Burimet e financimit të konsumit janë rritur në këtë tremujor, por pasiguria e vlerësuar në nivele ende të larta ka ndikuar në kanalizimin e një pjese të mirë të të ardhurave drejt kursimeve[30]. Rritja e indeksit të fondit të pagave[31], si dhe flukset hyrëse të remitancave kanë mbështetur rritjen e të ardhurës së disponuar. Gjithashtu, rritja e kredisë konsumatore u përshpejtua në tremujorin e dytë dhe standardet e kredisë për individët u lehtësuan.

Grafik 26. Ecuria e konsumit privat dhe besimit në sektorin e tregtisë



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket tremujorit të tretë, treguesit e pjesshëm sinjalizojnë vijimësi të konsumit të dobët. Kjo pritet të shfaqet më tepër në uljen e shpenzimeve për pajisje afatgjata konsumi e për shërbime, dhe më pak në shpenzimet për mallra të konsumit të përditshëm. Balanca e blerjeve të mëdha nga vrojtimi i besimit konsumator dhe treguesi i besimit të shërbimeve ka pësuar rënie në tremujorin e tretë. Importi i mallrave ushqimore dhe treguesi i besimit të tregtisë janë rritur në këtë tremujor.

Grafik 27. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e tretë



*Rritja e importit të mallrave ushqimore të tremujorit të tretë është përafruar nga rritja vjetore mesatare e muajve korrik dhe gusht 2015.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[29] *Bazuar në të dhëna të disagreguara të prodhimit të brendshëm bruto, sipas metodës së prodhimit dhe mbi indeksin e tregtisë me pakicë.*

[30] *Për më shumë, shih hapësirën informuese 5 "Matja e pasigurisë ekonomike dhe lidhja me konsumin dhe investimet".*

[31] *I referohet indeksit të fondit të pagave për totalin e aktiviteteve të mbuluara nga anketa e statistikave afatshkurtra deri në tremujorin e dytë të vitit 2015, të INSTAT-it. Më konkretisht, indeksi regjistroi rritje vjetore prej 7.6% në tremujorin e dytë të vitit 2015, pas zgjerimit vjetor me rreth 9.4% në tremujorin e mëparshëm. Indeksi i fondit të pagave është pjesë e treguesve ekonomikë të statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike të publikuar nga INSTAT-i. Ai është një indeks përafrues i ecurisë së fondit të pagave në njësinë e vrojtuar.*

Grafik 28. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

Investimet u rritën me 19% në tremujorin e dytë, duke vijuar të jenë një nga kontribuesit kryesorë në formimin e kërkesës agregate në vend. Rritja e këtij komponenti përfitoi nga hyrja e investimeve të huaja direkte, si dhe nga rritja e shpenzimeve kapitale publike të lidhura me infrastrukturën në tremujorin e dytë[32]. Investimet në ndërtim, të cilat kanë peshën më të madhe në investimet totale, kanë dhënë kontributin kryesor në rritje[33]. Investimet në makineri dhe pajisje vlerësohen të jenë rritur gjithashtu, bazuar në rritjen e importit të tyre me 8.6% në tremujorin e dytë[34].

Kontributi pozitiv i investimeve pritet të vijojë në tremujorin e tretë. Rritja e treguesit të besimit në ndërtim dhe e balancës së investimeve të reja sinjalizojnë vijim të investimeve në ndërtim. Kontributi i pritur i investimeve në makineri dhe pajisje është gjithashtu pozitiv. Të dhënat paraprake të tremujorit të tretë shfaqin rritje mesatare 12.2% të importit të makinerive dhe pajisjeve. Gjithashtu, rritja e investimeve publike në tremujorin e tretë pritet të ketë mbështetur formimin bruto të kapitalit fiks.

Grafik 29. Tregues afatshkurtër të investimeve private për tremujorin e dytë dhe të tretë



*Rritja e tremujorit të tretë është përafruar nga rritja vjetore mesatare e muajve korrik dhe gusht 2015.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[32] *Shpenzimet kapitale lokale shënuan një rritje të konsiderueshme në tremujorin e dytë të vitit.*

[33] *Vlera e shtuar në ndërtim u rrit me 24.5% në tremujorin e dytë dhe vlera e lejeve të ndërtimit u dyfishua këtë tremujor, në krahasim me një vit më parë.*

[34] *Bazuar në strukturën e formimit bruto të kapitalit fiks në vitin 2013, investimet në ndërtim zënë një peshë prej 75%, në makineri dhe pajisje 12%, në mjete transporti 6%, në kërkime mineralesh 3% dhe në bujqësi 4%. Investimet në programe kompjuterike dhe databaza zënë një peshë pothuaj 0% në formimin bruto të kapitalit fiks në vend.*

*HAPËSIRË INFORMUESE 5: MATJA E PASIGURISË EKONOMIKE DHE LIDHJA ME KONSUMIN DHE INVESTIMET**

Një nga arsyet që ekonomistët japin për rikuperimin e ngadaltë të ekonomive të Eurozonës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës pas krizës së vitit 2008, është niveli i lartë i pasigurisë[1]. Të pasigurt për të ardhmen, bizneset ndaluan së investuari e punësuari dhe konsumatorët shtynë në kohë blerjet e tyre. Në vendin tonë, një nga kanalet e përcjelljes së krizës botërore ishte lëkundja e besimit të agjentëve ekonomikë dhe ngadalësimi i ritmit të rritjes së aktivitetit ekonomik.

Përkufizimi më i hershëm për pasigurinë e sheh atë si pamundësinë për të parashikuar ndodhjen e ngjarjeve të caktuara (Frank Knight, 1921). Në një ambient ku pasiguria është e lartë, bizneset hezitojnë të kryejnë investime sepse shpesh investimet janë të kushtueshme për t'u kthyer pas[2]. Në mënyrë të ngjashme, konsumatorët shtyjnë konsumin dhe rrisin kursimet.

Pasiguria ekonomike nuk mund të matet drejtpërdrejt si treguesit e tjerë, si për shembull inflacioni apo prodhimi. Megjithatë, mund të ndërtohen tregues që përafrojnë pasigurinë në ekonomi, duke përdorur matje të tjera si për shembull: luhatshmëria e çmimeve të letrave me vlerë, tregues nga vrojtimet e besimit, ndryshueshmëria e parashikimeve të parashikuesve profesionistë, monitorimi në media i togfjalëshave që përmbajnë brenda pasigurinë[3] etj. Më poshtë do të paraqesim një matje të pasigurisë ekonomike në Shqipëri, duke përdorur të dhëna në nivel të detajuar të vrojtimeve të bizneseve dhe të konsumatorëve.

***Treguesi i pasigurisë nga pritje heterogjene (TPE_pritje)** llogaritet si për bizneset dhe për konsumatorët. Nëse bizneset dhe konsumatorët, në një periudhë të caktuar, kanë pritje pak a shumë të njëjta për të ardhmen (përgjigjet e pyetjeve përqendrohen në njërën nga alternativat e përgjigjes), shkalla e pasigurisë konsiderohet e ulët, dhe anasjellas. TPE kuantifikon shkallën e shpërndarjes së përgjigjeve midis alternativave të ndryshme të pyetjes, nëpërmjet ndërtimit të indeksit të Theil-it[4]:*

$Th=1/[N*(ln(N)]*\sum^{N}_{i=i}[x_i*ln(x_i/x)]$, ku x_i është pjesa e përgjigjeve të një alternative dhe N është numri i alternativave të përgjigjes së pyetjes.

Indeksi i Theil merr vlera nga 0 deri në 1. Nëse përgjigjet janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha alternativat e pyetjes, indeksi merr vlerën më të vogël dhe tregon për pasiguri të lartë. Indeksi merr vlerën 1, nëse të gjithë agjentët kanë zgjedhur vetëm një alternativë. Në këtë rast, pasiguria është në nivelet minimale. Për të lehtësuar analizën dhe interpretimin, treguesi i pasigurisë është llogaritur si TPE_pritje=1-Th. Në këtë rast, vlerat e treguesit të pasigurisë bien në intervalin (0-1), por 1 tregon maksimumin e pasigurisë.

***Treguesi i Pasigurisë nga Gabimi në Parashikim (TPE_par)** ndërtohet vetëm për bizneset dhe mat gabimin e parashikimit të tyre në një tremujor, duke krahasuar treguesin e parashikuar me ecurinë faktike në tremujorin e ardhshëm. Metodologjia e kryerjes së vrojtimeve të besimit, e cila bazohet në vëzhgimin e një kampioni të fiksuar biznesesh në kohë, mundëson këtë lloj krahasimi. Gabimi i parashikimit të bizneseve analizohet, duke u bazuar në pyetjen mbi prodhimin[5]. Më konkretisht, përgjigjja e pyetjes së bërë në tremujorin t, "si mendoni do të jetë ecuria e prodhimit në firmën tuaj në tremujorin e ardhshëm?", krahasohet me përgjigjen e dhënë nga i njëjti biznes në tremujorin t+1, "si është paraqitur ecuria e prodhimit në firmën tuaj gjatë tremujorit të kaluar?". Gabimi i parashikimit kodohet në mënyrë të ngjashme me metodologjinë e zbatuar nga Bachman dhe të tjerë (2012). Për shembull, nëse biznesi zgjedh të njëjtën alternativë në të dy tremujorët, atëherë parashikimi i tij në tremujorin t është i saktë ose gabimi në parashikim është 0, pavarësisht se mund*

të ketë zgjedhur alternativën pozitive, negative apo neutrale6). Nëse përgjigjja e pyetjes në tremujorin t+1 është e ndryshme nga parashikimi i bërë një tremujor më parë, paraqiten mundësitë e mëposhtme të kodimit:

Pritjet në t për t+1 /Vlerësim në t	Është rritur	E njëjtë	Është ulur
Do të rritet	0	-1	-2
Do të mbetet e njëjtë	+1	0	-1
Do të ulet	+2	+1	0

Nga krahasimi përfitohet një seri "gabimesh" për secilin biznes në çdo tremujor të vëzhguar t. Devijimi standard i kësaj serie përbën treguesin e pasigurisë ekonomike të matur nga gabimi në parashikim, TPE_part=dev.std (gabimi i parashikimit).

Grafik 30. Treguesit e pasigurisë ekonomike (TPE) të matur nga shpërndarja e pritjeve dhe nga gabimi në parashikim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun 30, paraqitet treguesi i pasigurisë për bizneset i ndërtuar në të dyja mënyrat, nga gabimi në parashikim dhe nga shpërndarja e pritjeve, si dhe treguesi i pasigurisë së konsumatorëve i matur nga metoda e dytë. Me gri janë identifikuar periudhat pas krizës globale të vitit 2008 dhe pas krizës financiare të Eurozonës së vitit 2011. Gjatë këtyre dy periudhave, të tre treguesit e pasigurisë regjistruan rritje, por më të sinkronizuar në të parën. Treguesi i pasigurisë së konsumatorëve vijoi të mbetet në nivele të larta edhe pas vitit 2008, sipër mesatares së vet historike. Niveli i tij ra për herë të parë pas një periudhe 4-vjeçare nën mesataren afatgjatë në vitin 2013. Ndërkohë, treguesit e pasigurisë së bizneseve kanë paraqitur një sjellje ciklike më të theksuar dhe shkallë më të lartë luhatshmërie. Gjatë vitit të fundit, pasiguria e perceptuar nga bizneset dhe nga konsumatorët është e ndryshme: treguesi i pasigurisë së konsumatorëve ka regjistruar prirje rritëse, ndërsa treguesit e pasigurisë së bizneseve kanë qëndruar nën mesataren e tyre afatgjatë.

Në grafikun 31 paraqiten treguesit e pasigurisë së bizneseve dhe ecuria vjetore e investimeve në ekonomi (grafiku majtas) dhe treguesi i pasigurisë së konsumatorëve me ecurinë e konsumit privat (grafiku djathtas). Pamja grafike sugjeron se treguesit e pasigurisë janë kundërciklikë. Në periudhat kur pasiguria bie, agregatët ekonomikë

Grafik 31. TPE-të e bizneseve dhe rritja vjetore e investimeve, grafiku majtas dhe TPE-të e konsumatorëve dhe rritja vjetore e konsumit privat, grafiku djathtas



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

kanë regjistruar rritje dhe anasjellas. Kjo është në përputhje me teorinë ekonomike, sipas së cilës treguesit e pasigurisë lidhen negativisht me rritjen ekonomike përgjatë ciklit të biznesit. Gjatë vitit 2015, mjedisi i karakterizuar nga nivele të ulëta të pasigurisë së bizneseve ka mbështetur rritjen e investimeve në ekonomi. Në të kundërt, prirja rritëse e pasigurisë së konsumatorëve është reflektuar në rënien e konsumit privat. Rritja e pasigurisë ka ndikuar veçanërisht konsumin e mallrave afatgjata, i cili ka një kërkesë elastike dhe mund të shtyhet në kohë, ndërkohë që individët presin që situata të jetë më e qartë (për më shumë shih seksionin 4.2.2-Zhvillimet e kërkesës agregate).

Shënime:

** Kjo hapësire informuese është përgatitur nga Ermelinda Kristo, Departamenti i Politikës Monetare.*

1) Bloom, N, Kohse, M., Terrones, M. 2013: "Held back by uncertainty", Finance and Development, March.

2) Bernanke, B, 1980: "Irreversibility, uncertainty and cyclical investment", NBER, material studimor nr.502, korrik 1980.

3) Disa materiale ku përdoren lloje të ndryshme të treguesve të pasigurisë janë: Baker dhe Bloom 2013: "Does uncertainty reduce growth? Using disasters as natural experiments", NBER material studimor nr.19475; Bloom, N. 2014: "Fluctuations in Uncertainty", Journal of Economic Perspectives, Volumi 28, Nr.2, fq 153-176; Bloom, N 2009: "The impact of uncertainty shocks", Econometrica, Vol. 77, nr.3; Niemira, M. 1996: "Measuring consumer uncertainty"; Kose dhe Terrone, 2012: "How does uncertainty affect economic performance?", World economic outlook, tetor 2012, fq. 69.

4) Fillimisht, indeksi i Theil është përdorur si matës i pabarazisë ekonomike. Në materialin studimor të Balta, N, Ferdinandez, I dhe Ruscher, E, 2013: "Assessing the impact of uncertainty on consumption and investment", indeksi kuantifikon pasigurinë nga vrojtimet e harmonizuara të besimit të biznesit dhe të konsumatorit të organizuara nga Komisioni Evropian.

5) Çdo tremujor janë krahasuar përgjigjet mbi prodhimin e rreth 400 bizneseve të sektorit të industrisë dhe të ndërtimit.

6) Përgjigjet e pyetjes së bizneseve mbi prodhimin ndahen në tre kategori: rritur, nuk ka ndryshim dhe ulur.

4.2.3. KËRKESA E SEKTORIT PUBLIK DHE POLITIKA FISKALE

Në nëntë muajt e parë të vitit, stimuli fiskal ka rezultuar thuajse neutral. Bilanci primar është rikthyer në territor pozitiv në tremujorin e tretë të vitit. Grumbullimi i të ardhurave është rritur në terma vjetorë, ndërsa shpenzimet kanë qëndruar thuajse në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore janë rritur me 0.1% në nëntë muajt e parë të vitit, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 297.6 miliardë lekë. Shpenzimet korrente janë rritur me rreth 3.3% në terma vjetorë, nxitur nga rritja e shpenzimeve operative dhe atyre për pushtetin lokal. Shpenzimet për shërbimin e

Grafik 32. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar*



*Stimuli fiskal është përafruar nga ndryshimet e raporteve të deficitit primar tremujor kumulativ ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Ndryshimet pozitive në këto raporte tregojnë stimul pozitiv fiskal, ndërkohë që diferencat negative sinjalizojnë konsolidim fiskal.
Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

borxhit janë tkurrur, duke vijuar të ndjekin tendencën e këtij viti. Shpenzimet kapitale janë rritur në 10.4%, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 33 miliardë lekë në nëntë muajt e parë të vitit. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura është tkurrur me 41.7% në terma vjetorë, duke tërhequr poshtë rritjen e shpenzimeve totale, si pasojë e bazës së lartë krahasuese të një viti më parë[35].

Shpenzimet totale janë shpërndarë thuajse në mënyrë uniforme nëpër tremujorë, ndërsa shpenzimet kapitale janë përqendruar më tepër në tremujorin e dytë dhe të tretë. Pagimi i detyrimeve të prapambetura është përqendruar në gjysmën e parë të vitit dhe thuajse gjysma e tyre është kryer në tremujorin e parë.

Grafik 33. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve dhe zërave kryesorë (majtas); kontributi i përbërësve kryesorë të shpenzimeve tek shpenzimet totale (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

Në tremujorin e tretë të vitit, shpenzimet janë rritur me 2%, krahasuar me të njëjtin tremujor një vit më parë. Shpenzimet korrente dhe kapitale janë rritur përkatësisht me 5.1% dhe 20% në terma vjetorë, ndërsa shlyerja e detyrimeve të parakohshme ka shënuar një tkurrje të fortë.

Të ardhurat buxhetore janë realizuar në rreth 279 miliardë lekë për nëntë muajt e parë të vitit, duke shënuar një rritje prej 4.6% në terma vjetorë. Rritja është mbështetur kryesisht tek ecuria e mirë e rritjes së nënzërave "Tatimi mbi fitimin"[36], "Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore"[37] dhe "Tatimi

[35] *Deri në muajin shtator janë shlyer rreth 75% e detyrimeve të prapambetura të planifikuara për gjithë vitin. Rreth 37% e tyre konsistojnë në detyrime të infrastrukturës, ndërsa rreth 35% përbëhen nga detyrime të prapambetura tatimore.*

[36] *Që prej datës 1 janar 2015, pas ndryshimeve ligjore, norma e tatimit për fitimet nga depozitat në sistemin bankar u rrit në 15%, nga 10% që ishte deri para kësaj date.*

[37] *Më datë 1 janar hyri në fuqi Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", nëpërmjet të cilit u vendos rritja e pagës minimale mbi të cilën llogariten detyrimet për të deklaruarit si të vetëpunësuar dhe për punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin. Kjo rritje, bashkë me rritjen e efektivitetit të administratës tatimore, ka sjellë edhe rritjen e të ardhurave nga kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.*

mbi të ardhurat personale", të cilët janë rritur përkatësisht me 13.6%, 12.4% dhe 7.3%. "Tatimi mbi vlerën e shtuar" është tkurrur me 1.4% në terma vjetorë, por ka ndjekur një trajektore në përmirësim. Pas disa muajve perfomancë pozitive, të ardhurat nga akcizat kanë ngadalësuar ritmin e rritjes vjetore, në 0.8%. "Të ardhurat jotatimore" janë rritur me 30.6% në terma vjetorë[38], duke kontribuar me 1.2 pikë përqindjeje në rritjen e të ardhurave totale.

Grafik 34. Ndryshimi vjetor i zërave kryesorë të të ardhurave (majtas), dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave sipas kontributeve të zërave kryesorë (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

Në tremujorin e tretë të vitit, të ardhurat kanë shënuar një rritje vjetore prej 5%. Të ardhurat nga "Tatimi mbi vlerën e shtuar", "Tatimi mbi të ardhurat personale", "Taksat kombëtare" dhe "Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore" kanë ushqyer këtë rritje, ndërsa performanca negative e "Tatimit mbi fitimin" dhe "Akcizave" ka ndikuar në kahun e kundërt.

Grafik 35. Deficiti kumulativ / PBB (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij, në miliardë lekë (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit.

[38] *Të ardhurat jotatimore kanë pasqyruar rritjen e shpejtë të të ardhurave nga institucionet buxhetore, që pasqyrojnë shitjen e licencave për ofrimin e shërbimit 4G nga operatorët e telefonisë celulare.*

Deficiti buxhetor arriti 18.5 miliardë lekë në nëntë muajt e parë të vitit, duke u ngushtuar me rreth 39.5% vit mbi vit. Ai është financuar kryesisht nga burimet e huaja. Huamarrja e brendshme në nëntë muajt e parë të vitit ka arritur në 26.1 miliardë lekë. Për tremujorin e tretë, deficiti ka rezultuar 5.8 miliardë lekë, rreth 30.6% më i ulët se në të njëjtin tremujor një vit më parë.

4.2.4. KËRKESA E HUAJ DHE TREGTIA E JASHTME

Deficiti real tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua në tremujorin e dytë të vitit 2015. Zvogëlimi vjetor i deficitit me 23.2% dëshmon një përshpejtim të prirjes së nisur gjatë një tremujori më parë. Ecuria e eksporteve neto vlerësohet të ketë dhënë një kontribut pozitiv në ecurinë vjetore të kërkesës agregate, në rritje nga ai i regjistruar një tremujor më parë. Këtu, ndikim të qenësishëm dha rënia vjetore e importit real të mallrave e të shërbimeve. Nisur nga zhvillimet në tremujorin e dytë të vitit, projeksionet tona për deficitin e eksporteve neto për vitin 2015 janë rishikuar për lart.

Grafik 36. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT.

Të dhënat mbi ecurinë e eksporteve neto për tremujorin e tretë të vitit 2015, përfshijnë vetëm përbërësin e tregtisë në mallra për muajt korrik-gusht. Deficiti tregtar në mallra për këto dy muaj u zgjerua me rreth 8.5% në terma vjetorë, ku faktori përcaktues në nivel vjetor ishte rënia e eksporteve.

Grafik 37. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

Eksporti i mallrave në vlerë u zvogëlua me rreth 8.8% në nivel vjetor. Kontributin kryesor në këtë ecuri e dha rënia e eksportit të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike". Brenda kësaj kategorie ndikimin më të madh e ka dhënë zvogëlimi i eksportit të naftës me përafërsisht 34%, krahasuar me një vit më parë. Në anën tjetër, eksporti i energjisë elektrike shfaqi ritme pozitive rritjeje. Në kushtet e konjukturave të pafavorshme të çmimit në tregjet ndërkombëtare të mallrave bazë të metalit, eksporti i kategorisë "Materiale ndërtimi dhe metale" është zvogëluar si në vlerë, ashtu edhe në vëllim. Në anën tjetër, eksportet në kategorinë "Ushqim, pije dhe duhan" rezultuan rreth 38.6% më të larta këto dy muaj, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Eksporti i produkteve të përfshira në kategorinë "Tekstile dhe këpucë" u zgjerua me rreth 6.8% në nivel vjetor, duke dhënë edhe kontributin më të lartë të kahut pozitiv. Megjithatë, kontributi i kombinuar i këtyre dy kategorive nuk ishte i mjaftueshëm për të mbuluar efektin negativ të dhënë nga dy kategoritë e sipërpërmendura.

Aktiviteti importues rezultoi i rritur me rreth 0.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dinamika e importeve u përcaktua gjerësisht prej rritjes së importit të mallrave në kategoritë "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi", "Tekstile dhe këpucë" dhe "Ushqim, pije dhe duhan". Ecuritë pozitive të dy kategorive të para lidhen ngushtë me performancën e formimit bruto të kapitalit fiks për tremujorin e tretë të vitit dhe me ecurinë e pritur të industrisë tekstile që punon me material porositësi. Në anën tjetër, rritja e importit të kategorisë së fundit sinjalizon për një kërkesë më të lartë të brendshme për mallra konsumi. Importi i produkteve në kategorinë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" ka shfaqur prirje rënëse. Këtu, ndikim të kahut negativ ka dhënë si zvogëlimi i importit të energjisë elektrike, ashtu edhe ai i importit të produktit të naftës në vlerë.

Sipas orientimit gjeografik, eksportet vijojnë të jenë të orientuara drejt tregjeve të Italisë, të Kosovës, të Spanjës dhe të Gjermanisë. Ndërsa, origjina e produkteve të importuara paraqitet më e larmishme, ku vendet e BE-së mbajnë historikisht peshën kryesore ndaj totalit të importeve (62% gjatë këtij viti).

HAPËSIRË INFORMUESE 6: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2015

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 181.3 milionë eurosh në tremujorin e dytë të vitit 2015. Për të dytin tremujor radhazi, deficiti korrent ndoqi prirje ngushtuese me rreth 42.9% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 6.7% ndaj PBB-së nominale. Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente, kontribut në kahun ngushtues dhanë përmirësimi i bilancit të eksporteve neto dhe të ardhurat dytësore më të larta, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Importet e mallrave dhe të shërbimeve shënuan rënie me rreth 10.6% dhe eksportet ranë me rreth 1.9% në terma vjetorë. Bilanci i llogarisë së të ardhurave dytësore vijoi prirjen zgjeruese të nisur në tremujorin e dytë të vitit 2014. Në terma vjetorë, ato u rritën me rreth 19.7%. Nënzëri kryesor i kësaj kategorie, flukset hyrëse të dërgesave prej emigrantëve, ishte rreth 17.6% më i lartë në terma vjetorë. Deficiti i të ardhurave parësore vijoi

prirjen thelluese për të gjashtin tremujor radhazi. Ky i fundit dha ndikim të kahut zgjerues në ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente. Në terma strukturorë, i matur sipas hendekut kombëtar midis kursimeve dhe investimeve, sektori privat luajti rol kryesor në formimin e deficitit korrent.

Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale shënuan vlerën e 21.3 milionë eurove. Flukset valutore neto në llogarinë financiare, u zvogëluan me rreth 18.6% në nivel vjetor dhe financuan 96.9% të deficitit të llogarisë korrente. Investimet e huaja direkte neto u zgjeruan me rreth 39.7% në terma vjetorë. Në anën tjetër, investimet e tjera neto u vlerësuan në një tepricë neto pozitive prej rreth 72.6 milionë eurosh, ndikuar kryesisht nga rritja e mjeteve vendase të investuara jashtë. Në të kundërt, investimet e portofolit neto u zvogëluan me rreth 75.2 milionë euro. Në ndarjen e financimit të deficitit korrent, sipas flukseve financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese, vërehet një mbështetje më e theksuar ndaj formës së dytë të financimit. Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zgjerim të mjeteve të rezervës valutore me 111.8 milionë euro. Në fund të muajit qershor, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.4 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin me 5.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh dhe për mbulimin e 192% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zgjerim të mjeteve të rezervës valutore me 16.2 milionë euro. Në fund të muajit qershor 2015, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.38 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin me 6.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh dhe për mbulimin e 161.7% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave

	T1 '14	T2 '14	T3 '14	T4 '14	T1 '15	T2 '15
Llogaria korrente (në mil euro)	-271.5	-341.0	-313.2	-377.5	-242.0	-181.3
vmv (%)	21.3	19.5	64.0	12.0	-16.8	-42.9
/ PBB-së (%)	-11.7	-12.8	-12.6	-14.5	-10.6	-6.7
Mallra dhe shërbime	*-396.2*	*-473.3*	*-462.8*	*-536.0*	*-374.6*	*-366.9*
Eksporte, f.o.b.	608.8	752.0	838.8	757.1	591.8	699.1
Importe, f.o.b.	1005.0	1225.3	1301.6	1293.1	966.4	1066.0
Udhëtime neto	*-21.8*	*10.6*	*32.0*	*66.0*	*43.6*	*76.4*
Të ardhura parësore	*-20.6*	*-43.3*	*-48.7*	*-47.0*	*-48.2*	*-24.6*
Kredi	28.7	25.7	28.3	27.8	27.2	24.7
Debi	49.3	69.1	77.0	74.8	75.4	49.3
Të ardhura nga IHD-neto	*-30.4*	*-47.1*	*-56.2*	*-38.6*	*-50.7*	*-28.3*
Të ardhura dytësore	*145.3*	*175.6*	*198.3*	*205.4*	*180.7*	*210.2*
Kredi	172.6	204.4	230.6	244.1	211.9	243.3
Debi	27.3	28.8	32.3	38.8	31.2	33.0
Dërgesa nga emigrantët -neto	*118.2*	*137.5*	*165.1*	*171.0*	*141.8*	*161.7*
Llogaria kapitale	22.5	22.4	20.7	21.1	26.0	21.3
Huamarrje neto/huadhënie neto	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4	-216.1	-160.0
Llogaria financiare	-199.1	-214.5	-206.1	-285.9	-194.9	-175.8
vmv (%)	57.2	-18.3	190.7	26.5	-19.8	-18.6
/ PBB-së (%)	-8.6	-8.0	-8.3	-10.9	-8.6	-6.5
Investime direkte	*-168.0*	*-150.4*	*-253.4*	*-229.4*	*-278.3*	*-189.3*
Investime portofoli	*14.5*	*14.0*	*-12.4*	*104.7*	*-82.9*	*-75.2*
Derivativë financiarë	*0.0*	*0.0*	*0.0*	*0.0*	*0.0*	*0.0*
Investime të tjera	*-5.2*	*-100.6*	*-94.2*	*-122.2*	*54.5*	*72.6*
Mjetet e rezervës	*-40.3*	*22.5*	*154.0*	*-38.9*	*111.8*	*16.2*
Gabime dhe harresa	49.9	104.2	86.4	70.5	21.2	-15.8
Huamarrje neto/huadhënie neto	-249.0	-318.7	-292.5	-356.4	-216.1	-160.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË

Aktiviteti ekonomik vijon të rritet, por shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese mbetet nën potencial. Presionet inflacioniste nga ekonomia reale janë dhe parashikohen të mbeten të ulëta në afat të shkurtër. Përmirësimi i pritur ciklik i ekonomisë gjatë viteve në vijim vlerësohet të kontribuojë në mbylljen e hendekut negativ të prodhimit dhe në kthimin e inflacionit pranë objektivit në fillim të vitit 2018.

Presionet inflacioniste nga ekonomia e brendshme janë të ulëta, në reflektim të kërkesës së dobët konsumatore dhe të shfrytëzimit nën potencial të kapaciteteve prodhuese. Tregu i punës vazhdon të karakterizohet nga veprimtari me dinamikë të ulët, ku rritja në shkallën e punësimit balancohet nga rritja në shkallën e pjesëmarrjes në punë. Rrjedhimisht, shkalla e papunësisë ruajti nivelin prej 17.3% në tremujorin e dytë të vitit. Gjithashtu, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve, e raportuar nga bizneset në vrojtimet e besimit, vijon të qëndrojë nën mesataren historike. Krahas këtyre treguesve, vlerësimet tona për madhësinë e hendekut të prodhimit tregojnë se ai vijon të jetë negativ, duke ushtruar presione të dobëta për rritjen e kostove në ekonominë e brendshme.

Grafik 38. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë



*Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve dhe mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve e i normës së papunësisë është llogaritur si devijim i vlerës aktuale ndaj asaj mesatare historike.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në vlerësimin tonë, rritja më e shpejtë e ekonomisë e pritur gjatë viteve në vazhdim do të reduktojë madhësinë e kapaciteteve të pashfrytëzuara në tregun e punës e të kapitalit. Hendeku negativ i prodhimit parashikohet të mbyllet gradualisht gjatë vitit 2016 dhe rritja ekonomike t'i afrohet potencialit në fillim të vitit 2017. Përmirësimi ciklik i ekonomisë pritet të shoqërohet me presione për rritjen graduale të kostove të prodhimit dhe të çmimeve të konsumit dhe inflacioni parashikohet t'i afrohet objektivit në fillim të vitit 2018.

4.4. ECURIA E INFLACIONIT

Zhvillimet në çmimet e produkteve ushqimore, në veçanti të atyre të papërpunuara, kanë përcaktuar pjesën më të madhe të normës së inflacionit gjatë periudhës janar-shtator 2015. Në tremujorin e tretë, kategoritë e mallrave ushqimore kanë dhënë kontribut më të lartë sesa vetë vlera e inflacionit total. Ky kontribut është zbutur nga ndikimi negativ i kategorisë "Mallra të konsumit joushqimor". Efektet e veprimit disinflacionist, të cilat e zhvendosën kurbën e inflacionit në kahun rënës në periudhën maj-korrik, u shuan plotësisht në dy muajt e fundit të tremujorit, duke përforcuar vlerësimin se efektet e rënies së çmimeve në periudhën e mësipërme ishin të përkohshme.

Luhatshmëria e çmimeve të mallrave ushqimore të përdorimit të përditshëm ka qenë e ndjeshme gjatë këtij viti, duke bërë që inflacioni mujor i tyre në shumë raste të devijojë nga mesatarja sezonale. Kjo karakteristikë u shfaq më e dukshme në tremujorin e tretë të vitit. Pasi pësuan një rritje të papritur në tremujorin e parë, kontributi i çmimeve të ushqimeve filloi të reduktohet ndjeshëm, duke u përgjysmuar në muajin korrik, krahasuar me muajin prill të këtij viti[39]. Në dy muajt e fundit, kontributi i kësaj kategorie pësoi përsëri rritje, duke u rikthyer në nivelet e tremujorit të parë[40].

Grafik 39. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kategoria "Mallra të konsumit joushqimor" ruajti kontributin negativ prej 0.2 pikë përqindjeje tek norma e inflacionit total. Ecuria e inflacionit të kësaj kategorie është ndikuar nga rënia vjetore e çmimit të karburanteve, e cila vjen pas disa muajsh rritjeje. Kontributi i kategorisë "Mallra me çmime të rregulluara" në formimin e inflacionit të përgjithshëm ishte 0.1 pikë përqindjeje, duke mbetur në mesataren e tij në harkun kohor 1-vjeçar. Kategoritë e tjera me peshë më të vogël, në përgjithësi, vazhdojnë të japin një kontribut të ulët në vlerën e inflacionit vjetor.

Tabelë 5. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje)

	T3:13	T4:13	T1:14	T2:14	T3:14	T4:14	T1:15	T2:15	T3:15
Ushqime të përpunuara (pp)	0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	0.2	0.3	0.2	0.1
Bukë dhe drithëra (pp) *	0.1	0.0	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0
Alkool dhe duhan (pp)	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	0.8	1.7	1.8	1.8
Fruta (pp)	0.8	0.5	0.7	0.7	0.2	0.4	0.5	0.8	0.8
Perime(pp)	0.5	1.1	0.9	0.6	1.2	0.2	1.1	0.9	0.9
Shërbime (pp)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.0	0.0
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Strehim (pp)	0.0	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1	-0.1	0.0
Mallra konsumi joushqimor	-0.4	-0.2	0.2	0.2	0.2	0.0	-0.4	-0.2	-0.2
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v %)	1.5	1.5	1.9	1.6	1.7	1.3	1.9	1.8	1.8

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

4.4.1. PËRBËRËSIT AFATGJATË TË INFLACIONIT

Zhvillimet në prirjen afatgjatë dhe në atë me origjinë të brendshme të inflacionit vijuan të reflektojnë presionet e dobëta nga faktorë të kërkesës dhe nga kostot e punës dhe të prodhimit në ekonomi gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015.

[39] *Kontributi i kësaj kategorie u përgjysmua në mesin e vitit 2015, nga 2.3 pikë përqindjeje në prill, në 1.2 pikë përqindjeje në korrik.*

[40] *Në muajin shtator, kontributi i kësaj kategorie tek totali shënoi vlerën 2.2 pikë përqindjeje.*

Inflacioni bazë[41] dhe ai i sektorit të patregtueshëm të IÇK-së[42] rezultuan përkatësisht rreth vlerave -0.2 % dhe rreth 0.01%, vlera këto më të ulëta sesa në tremujorin e kaluar dhe dukshëm nën mesataren e dekadës së fundit.

Veprimi i faktorëve me natyrë afatshkurtër të krahut të ofertës, u reflektua në luhatjet e vlerave të inflacionit vjetor jobazë dhe atij të mallrave të tregtueshme të shportës së IÇK-së gjatë tremujorit. Në terma mesatarë, ata rezultuan përkatësisht rreth 5.02% dhe 2.90%, duke iu afruar mesatareve përkatëse të periudhës 2005-2015.

Grafik 40. Prirjet afatgjata (majtas) dhe afatshkurtra të inflacionit (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Vlerat e ulëta të inflacionit total, bazë dhe të brendshëm, edhe në këtë tremujor, u përcaktuan nga presionet e dobëta inflacioniste në ekonomi, të gjeneruara nga prania e hendekut negativ të prodhimit.

Grafik 41. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit*



*Mbi ndryshimet vjetore të treguesve janë zbatuar mesataret lëvizëse me 4 terma, për të zbutur luhatjet e rastit.
Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Pagat, produktiviteti dhe kostot e punës e të prodhimit[43]

Ritmet rritëse vjetore të treguesit të kostove të punës për njësi, u ngadalësuan përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 (3.9%). Ky ngadalësim reflektoi frenimin e prirjes rënëse të treguesit të produktivitetit të punës dhe rritjen më të ngadaltë të indeksit të

[41] *I matur sipas metodës së përjashtimit të përhershëm.*

[42] *Inflacioni i patregtueshëm dhe ai i tregtueshëm u referohen ndryshimeve në IÇK-të e nënshportave përkatëse, ku ajo e të patregtueshmeve përbëhet kryesisht nga shërbime dhe mallra, ndërsa ajo e të tregtueshmeve vetëm nga mallra.*

[43] *Treguesit përafrues të produktivitetit të punës dhe të kostove të punës për njësi të prodhuar, llogariten nga Banka e Shqipërisë, duke përdorur seritë totale të Statistikave Afatshkurtra (SASH, INSTAT, T2'2015). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indeksi i të punësuarve me pagesë, i xhiros dhe i fondit të pagave për totalin e aktiviteteve të mbuluara nga anketa e SASh.*

fondit të pagave. Për të njëjtën periudhë, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit (IÇP) industrial regjistroi rënie thuajse të njëjtë me atë të tremujorit të kaluar (-1%). Zhvillimet në këta tregues sugjerojnë vijimin e presioneve të dobëta inflacioniste nga krahu i pagave dhe i kostove prodhuese.

4.4.2. INFLACIONI I IMPORTUAR

Inflacioni i importuar vlerësohet si kontribuesi kryesor në vlerën e inflacionit total vjetor, në kushtet kur ai i brendshëm mbetet me një kontribut të neglizhueshëm negativ në këtë tremujor. Këto vlerësime mbartin edhe efekte statistikore të bazave krahasuese, që pritet të jenë të pranishme edhe në tremujorin pasardhës.

Grafik 42. TPHI-të dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Ashtu si edhe në tremujorin e kaluar, indeksi që përafron presionet e pritura inflacioniste me prejardhje nga partnerët tregtarë (TPHI[44]), ngadalësoi ritmet e rritjes vjetore. Të dhënat për tremujorin e tretë të vitit 2015 tregojnë për vijimësinë e normave të ulëta të inflacionit në vendet e Bashkimit Evropian. Treguesi i "Çmimeve të huaja"[45], i cili u zgjerua me 3.4% në terma vjetorë (1.2 pikë përqindjeje më lart së në tremujorin e dytë), u mbështet nga normat e inflacionit në Serbi dhe Turqi. Në të kundërt, nënçmimi i lehtë i lekut në terma të indeksit NEER (me rreth 0.9% në bazë vjetore) pati një kontribut periferik në transmetimin në vend të presioneve të huaja inflacioniste.

[44] *TPHI llogaritet si rritja vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit NEER për muajin përkatës. Presionet inflacioniste me origjinë të huaj vlerësohet që ndikojnë inflacionin me 1-3 muaj vonesë.*

[45] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së vendase. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat: e inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; dhe inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm Ushqime) për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë. Disa nga mallrat kanë shënuar rritje vjetore të çmimeve, ndërsa janë rritur edhe peshat e importeve me shtetet përkatëse. Kjo ka ndikuar që vlera përfundimtare e treguesit (mesatare e ponderuar e IÇK-ve të lartpërmendura me peshat mujore të importit të tyre), të shënojë një rritje jo pak të rëndësishme.*

4.4.3. PRITJET PËR INFLACIONIN[46]

Pritjet inflacioniste kanë qëndruar poshtë objektivit prej 3% dhe mesatares së tyre afatgjatë. Pritjet e agjentëve të ndryshëm për inflacionin janë luhatur në kahe të ndryshme gjatë tremujorit të tretë, bazuar në matje sasiore nga vrojtimet. Konsumatorët i kanë rishikuar për lart pritjet për inflacionin pas një viti. Norma e inflacionit e pritur prej tyre është 0.5 pikë përqindjeje më lart se norma e pritur në tremujorin e dytë. Në të kundërt, pritjet e agjentëve financiarë, të cilët kanë natyrën më të theksuar adaptive midis agjentëve të tjerë, kanë pësuar rënie, në reflektim të reduktimit të inflacionit zyrtar gjatë tremujorit të dytë. Pritjet e bizneseve për inflacionin pas një viti kanë rënë pak nga tremujori i kaluar (me -0.1 pikë përqindjeje) dhe qëndrojnë në nivelin më të ulët, krahasuar me nivelin e pritjeve të agjentëve të tjerë.

Grafik 43. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë dy viteve të fundit pritjet inflacioniste të agjentëve të ndryshëm të ekonomisë kanë qëndruar nën mesataren e tyre afatgjatë. Shkalla e ankorimit të pritjeve të konsumatorëve është përmirësuar në tremujorin e tretë[47], siç tregon devijimi më i vogël i nivelit të pritjeve nga mesatarja e tyre afatgjatë.

[46] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezutatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, me frekuencë tremujore, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë, me frekuencë mujore.*

[47] *Shkalla e ankorimit është kuantifikuar si ndryshim i nivelit të pritjeve nga mesatarja e tyre afatgjatë, e cila është e ndryshme për agjentë të ndryshëm të ekonomisë.*

SHTOJCA STATISTIKORE | STATISTICAL APPENDIX

Tregues të përgjithshëm makroekonomikë	58	Main macroeconomic indicators
1. Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	58	Monetary developments and interest rates 1.
2. Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	58	Gross domestic product, price indexes and labor market 2.
3. Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	59	Balance of payments, reserves and exchange rate 3.
4. Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	59	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt 4.
1 SEKTORI FINANCIAR	60	FINANCIAL SECTOR 1
1-2 Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	61	Monetary survey of Bank of Albania 1-2
1-3.a Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Mjetet	62	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Assets 1-3.a
1-3.b Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Detyrimet	63	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Liabilities 1-3.b
1-4 Paraqitja monetare e bankave paradepozituese	64	Monetary survey of deposit money banks 1-4
1-5 Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	65	Sectoral balance sheet of savings and loan associations 1-5
1-6 Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	66	Monetary survey of other depository corporations 1-6
1-7 Paraqitja monetare e korporatave depozituese	67	Monetary survey of depository corporations 1-7
1-8.a Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	68	Monetary aggregates and their components 1-8.a
1-8.b Kundërpartitë e agregatëve monetarë	69	Counterparts of monetary aggregates 1-8.b
1-9 Depozitat në lekë sipas sektorëve	70	Lek denominated deposits by sectors 1-9
1-10 Depozitat në valutë sipas sektorëve	70	Foreign currency denominated deposits by sectors 1-10
1-11 Kredia për ekonominë sipas sektorit	71	Credit to economy by sector 1-11
1-12 Kredia sipas aktivitetit ekonomik	71	Loans by economic activity 1-12
1-13 Kredia për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	72	Business loans by purpose and currency 1-13
1-14 Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	73	Household loans by purpose and currency 1-14
1-15 Kredia sipas rretheve	74	Loans by districts 1-15
1-16 Normat e interesit të Bankës së Shqipërisë	74	Bank of Albania interest rates 1-16
1-17 Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhave	75	Interest rates on new deposits by currency 1-17
1-18 Normat e interesit për kreditë e reja sipas monedhave	76	Interest rates on new loans by currency 1-18
1-19 Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	77	Maturity breakdown of Treausury bills yields 1-19
1-20 Sistemi i pagesave ndërbankare	78	Interbank payment system 1-20
1-21 Shpërndarja rajonale e terminaleve të ATM & POS	78	Number of ATM & POS terminals by region 1-21
1-22 Numri i llogarive të klientëve në banka	78	Number of customers accounts with banks 1-22
2-2 Kurset e këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	79	Exchange rate 2-2
2 SEKTORI I JASHTËM	79	EXTERNAL SECTOR 2
2-1 a Bilanci i Pagesave	79	Balance of payments 2-1 a
2 SEKTORI I JASHTËM	80	EXTERNAL SECTOR 2
2-1 b Bilanci i Pagesave	80	Balance of payments 2-1b
2-3 Eksporti sipas grup mallrave	81	Export by commodity groups 2-3
2-4 Importi sipas grup mallrave	81	Import by commodity groups 2-4
2-5 Borxhi i jashtëm bruto	82	Gross external debt 2-5
3 SEKTORI FISKAL	82	FISCAL SECTOR 3
3-1 Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	82	Fiscal indicators regarding consolidated budget 3-1
3-2 Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	83	Domestic debt stock by instruments 3-2
4 SEKTORI REAL	84	REAL SECTOR 4
4-1 Prodhimi i brendshëm bruto sipas klasifikimit të aktivitetit ekonomik, (Metoda e Prodhimit NVE Rev 2)	84	Gross domestic product by economic activities, (Production Method NACE Rev 2) 4-1
4-2 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa)	85	Producer price index and construction cost index 4-2 (for dwellings)
Ndryshimet në % të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa) 3)	85	Change in % of producer price index and construction cost index (for dwellings) 3)
4-3 Indeksi i çmimeve të konsumit	86	Consumer price index 4-3
4-4 Punësimi, papunësia dhe pagat	87	Employment, unemployment and wages 4-4

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË

MAIN MACROECONOMIC INDICATORS

1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT

MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1.

Në miliardë lekë, përveç rasteve kur shënohet ndryshe, fund periudhe

In billions ALL, unless otherwise indicated, end of period

	Agregatët monetarë / Monetary aggregates			Depozitat[1] / Deposits[1]	Kredia[2] / Credit[2]	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së ribleres njëjavore 4 / Weekly repurchase agreement rate4
	M1	M2	M3			Depozita[3] / Deposits[3]	Kredi[3] / Loans[3]	Bono Thesari/ T. Bills	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2010	275.4	604.5	980.3	785.2	483.1	6.40	11.29	7.09	5.00
2011	276.9	647.0	1,070.1	875.2	541.9	5.87	11.17	6.95	4.75
2012	281.2	669.6	1,123.4	930.7	554.7	5.38	10.28	6.37	4.00
2013	295.9	693.2	1,149.0	950.1	547.9	4.17	9.52	3.66	3.00
2014	353.3	722.4	1,195.1	977.4	560.0	1.92	7.66	3.33	2.25

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO[5], INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS

GROSS DOMESTIC PRODUCT[5], PRICE INDEXES AND LABOR MARKET 2.

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë [6] / At current prices, in million ALL [6]				Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të konsumit (%) / Yearly changes in CPI (%)	Ndryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (NVE Rev.2) % Average Annual Changes of Producer Price Index (NACE Rev.2) %	Tregu i punës[6] * / Labor market[6] *	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB) / Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto /Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto / Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto / Gross National Income			Shkalla e punësimit / Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë / Unemployment rate (%)
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7	8	9
2010	3.7	1,239,644.6	22,494.7	-34,879.1	1,227,260.2	3.6	0.3	53.5	14.2
2011	2.5	1,300,624.1	18,020.7	-21,612.7	1,297,032.1	1.7	2.6	58.7	14.3
2012	1.4	1,332,811.0	12,441.5	-22,369.0	1,322,883.5	2.4	1.1	55.9	13.8
2013	1.1	1,350,554.8	1,793.9	1,165.6	1,353,514.3	1.9	-0.4	49.9	16.4
2014						0.7	-0.5	50.5	17.9

Burimi: INSTAT.

Source: INSTAT.

3. BILANCI I PAGESAVE, REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT

Në milionë euro, përveç rasteve kur shënohet ndryshe

BALANCE OF PAYMENTS, RESERVES AND EXCHANGE RATE 3.

In millions EUR, unless otherwise indicated

	Bilanci i llogarisë korrente / Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar / Of which:Trade balance (3+4)			Nga të cilat: Remitancat / Of which: Remittances	Investimet direkte neto / Direct investments, net	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe / Reserves in months of import	Kursi i këmbimit / Exchange rate	
									Mesatare e periudhës / Period average	
			Eksporti / Export	Importi / Import					ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2010[7]	-1,018.6	-2,082.7	1,171.5	-3,254.2	689.8	788.5	1,904.8	4.8	137.8	103.9
2011	-1,225.2	-2,241.6	1,405.5	-3,647.1	664.5	608.9	1,912.5	4.4	140.3	100.9
2012	-978.0	-1,999.2	1,525.6	-3,524.8	675.3	647.9	1,972.5	4.7	139.0	108.2
2013	-1,049.1	-1,840.5	1,743.7	-3,584.2	543.8	923.2	2,015.3	4.8	140.3	105.7
2013[8]	-1,049.1	-1,979.3	1,050.6	3,029.9	543.8	-923.2	2,015.3	5.4	140.3	105.7
2014	-1,287.2	-2,215.6	931.7	3,147.3	591.9	-811.5	2,191.7	5.6	140.0	105.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM

Në miliardë lekë

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4.

In billions ALL

	Të Ardhura / Revenue	Nga të cilat: Të ardhura tatimore / Of which: Tax revenue	Shpenzime / Expenditure	Shpenzime kapitale / Capital expenditure	Deficiti / Deficit	Financim i brendshëm / Domestic financing	Financim i huaj / Foreign financing	Stoku i borxhit të Qeverisë Qëndrore / Central government debt stock	
								Stoku i borxhit të brendshëm / Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2010	324.7	288.6	362.8	67.5	-38.0	13.2	24.9	407.4	308.0
2011	330.5	303.9	376.3	70.7	-45.8	26.1	19.8	438.6	333.9
2012	330.4	300.9	376.2	61.7	-45.9	26.5	19.4	470.4	357.6
2013	327.2	299.9	394.1	65.5	-66.9	56.1	10.8	520.8	363.9
2014	366.7	335.9	438.8	60.5	-72.1	42.2	29.9	564.7	412.4

Burimi: Ministria e Financave, sipas publikimeve "Statistikat fiskale, Janar-Gusht 2015" dhe Treguesit e Borxhit, 6 mujori i parë 2015".
Publikimi 'Statistika fiskale Janar-Gusht 2015' tabelat:
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (Vjetor).
Shënime:
1) Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.
2) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
3) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe kredive të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
4) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
5) PBB 2013 Gjysëm-finale. Të dhënat sipas INSTAT: Llogaritë Kombëtare Vjetore; Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e prodhimit), sipas NVE Rev 2 (tabela 1); Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e Shpenzimeve) (tabela gbi)
6) Të dhënat sipas informacionit në faqen e internetit të INSTAT datë 07.10.2015:
**Temat/ Tregu i punës/ Anketa e Forcave të Punës/ Vjetore/ Shkalla e punësimit 2007-2014 (grupmosha 15-64 vjeç); Shkalla e papunësisë 2007-2014 (grupmosha 15-64 vjeç).*
7) Të dhënat 2010-2013 janë hartuar sipas manualit të pestë të pagesave.
8) Të dhënat janë hartuar sipas manualit të gjashtë të bilancit të pagesave.

Source: Ministry of Finance, according to "Fiscal Statistics, January-August 2015" and "Debt Indicators, as of June 30, 2015" publications.
Publication ‹Fiscal statistics January- August 2015› table:
"Consolidated general budget (Annual)".
Footnote:
1) Deposits included in broad money.
2) Credit to economy.
3) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
4) End of period data.
5) GDP 2013 Semi final. The data as of INSTAT: Annual National Accounts , Annual National Accounts (Production Method), by NACE Rev 2 (table 1); Annual National Accounts (Expenditure Method) (gbi table)
6) Data as of INSTAT web page tables, date 07.10.2015:
**Figures/ Figures by theme/ Labour market/ Labour Force Survey/ Yearly/ Employment rate 2007-2014 (age group 15-64 years); Unemployment rate 2007-2014 (age group 15-64 years).*
7) The data 2010-2013 are compiled according to BPM5 IMF Manual.
8) Data presented are compiled according to BPM6 IMF Manual.

1 SEKTORI FINANCIAR

FINANCIAL SECTOR 1

In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve/ Total assets (2+ 3+ 4+ 5+ 8+ 12+ 13+ 14)	Ari monetar dhe mbajtjet e SDR*/ Monetary gold and SDR holdings*	Arka në valutë/ Foreign currency	Depozita/ Deposits	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities other than shares (6+7)			Huatë/ Loans (9+10+11)				Derivatet financiare/ Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme/ Receivable accounts	Mjete jofinanciare/ Nonfinancial assets
						Jorezidentë/ Nonresidents	Qeveria Qëndrore/ Central Government		Qeveria Qëndrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2012 / 12	394,833.6	17,703.3	67.5	30,517.5	294,007.2	229,313.1	64,694.1	23,706.8	_	21,800.2	1,906.5	14.2	14,129.2	14,688.0
2013 / 12	398,813.6	16,701.5	57.3	23,892.8	308,387.0	243,178.6	65,208.4	23,333.2	_	21,502.3	1,830.9	31.5	11,994.1	14,416.4
2014 / 12	433,878.0	19,299.7	56.2	32,524.0	320,744.6	256,796.7	63,947.9	27,286.3	_	25,547.8	1,738.5	17.4	18,197.8	15,752.1
2015 / 03	473,891.3	29,254.8	30.7	40,284.8	332,379.1	269,169.1	63,210.0	30,334.6	_	28,615.3	1,719.3	34.5	25,478.7	16,094.2
04	465,272.1	28,371.3	134.7	39,204.1	322,845.7	259,689.7	63,156.0	33,608.5	_	31,897.3	1,711.2	51.8	25,003.1	16,052.9
05	474,884.3	33,915.0	15.4	40,137.8	324,267.5	261,156.8	63,110.7	27,268.3	_	25,564.1	1,704.2	61.4	33,151.0	16,067.9
06	482,604.9	33,301.4	13.5	42,937.7	324,076.9	260,360.8	63,716.1	33,362.4	_	31,664.9	1,697.5	40.2	33,039.7	15,833.2
07	520,926.2	32,917.3	33.9	77,067.3	323,242.9	259,547.8	63,695.2	38,941.8	_	37,251.0	1,690.8	31.5	33,202.7	15,488.8
08	519,948.7	32,466.6	27.6	56,492.3	342,746.3	278,983.8	63,762.6	39,202.8	_	37,518.4	1,684.4	27.8	33,506.2	15,479.1

	Detyrimet totale/ Total liabilities (2+ 3+ 4+ 10+ 14+ 15+ 16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money (5+6+7+8+9)						Huatë / Loans (11+12 +13)				Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Alokimi i SDR/ SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit/ Shares and other equity
					Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria Qëndrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare/ Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors		Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria Qëndrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2012 / 12	394,833.6	200,898.7	187.3	120,691.0	10,042.9	12,887.1	97,054.7	37.2	669.2	3,870.7	3,870.7	_	_	1,680.5	7,557.9	59,947.5
2013 / 12	398,813.6	207,792.7	249.7	132,764.9	9,706.5	22,239.2	100,031.3	62.5	725.4	2,919.3	2,919.3	_	_	1,828.3	7,287.5	45,971.3
2014 / 12	433,878.0	226,434.1	154.2	140,569.3	16,564.1	16,600.5	106,310.9	85.0	1,008.8	2,294.2	2,294.2	_	_	889.8	7,753.2	55,783.2
2015 / 03	473,891.3	225,389.5	1,028.5	166,574.6	23,874.1	29,714.7	112,030.3	94.4	861.1	2,102.8	2,102.8	_	_	1,648.8	8,395.2	68,752.0
04	465,272.1	225,811.0	3,078.5	160,706.5	23,853.4	28,773.8	107,114.2	94.5	870.5	2,059.7	2,059.7	_	_	289.1	8,152.1	65,175.3
05	474,884.3	231,282.0	1,621.0	163,455.8	31,938.2	25,411.2	105,242.6	93.3	770.4	2,078.1	2,078.1	_	_	524.8	8,293.6	67,629.1
06	482,604.9	236,301.2	939.4	170,373.5	31,924.9	23,766.6	113,825.0	93.4	763.6	2,062.9	2,062.9	_	_	409.6	8,185.7	64,332.8
07	520,926.2	239,515.6	567.6	205,767.9	31,887.2	64,573.4	108,548.9	94.1	664.4	2,022.5	2,022.5	_	_	350.4	8,258.5	64,443.8
08	519,948.7	239,098.6	466.8	207,473.2	31,849.9	65,204.1	109,860.2	93.9	465.1	1,850.8	1,850.8	_	_	585.0	8,151.9	62,322.3

Burimi: Banka e Shqipërisë

** Për periudhën dhjetor 2002-prill 2014 është bërë riklasifikimi i arit monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Ari monetar dhe mbajtjet e SDR".*

Source: Bank of Albania.

** The data of December 2002-April 2014 reflect a reclassification of monetary gold from "Deposits " to " Monetary gold and SDR holdings".*

1-2 PARAQITJA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË
Në milionë lekë, fund periudhe

MONETARY SURVEY OF BANK OF ALBANIA 1-2
In millions ALL, end of period

	Mjete valutore neto/ Net foreign assets (2-3)	Pretendime ndaj jorezidentëve/ Claims on nonresidents	Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve/ Less: Liabilities to nonresidents	Mjetet e brendshme / Domestic assets (5+ 8+ 9+10+ 11+12)	Pretendime neto ndaj Qeverisë Qëndrore/ Net claims on Central Government (6-7)	Pretendime ndaj Qeverisë Qëndrore/ Claims on Central Government	Detyrime ndaj Qeverisë Qëndrore/ Less:Liabilities to Central Government	Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese/ Claims on other depository corporations Minus:	Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare/ Claims on other financial corporations	Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike / Claims on public nonfinancial corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare/ Claims on other nonfinancial corporations	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë/ Claims on other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2012 / 12	266,540.0	288,142.1	21,602.1	78,858.1	55,145.6	68,057.8	12,912.2	21,800.8	_	_	_	1,911.7
2013 / 12	274,198.2	294,111.3	19,913.2	67,841.8	44,503.1	66,768.8	22,265.7	21,502.9	_	_	_	1,835.8
2014 / 12	292,098.3	318,940.2	26,841.9	82,525.1	55,198.3	71,831.3	16,633.0	25,547.8	_	_	37.3	1,741.7
2015 / 03	314,436.3	349,332.6	34,896.3	77,731.6	47,350.5	78,059.0	30,708.5	28,615.3	_	_	41.9	1,724.0
04	303,394.3	337,586.5	34,192.3	82,786.8	49,173.2	78,001.2	28,828.0	31,897.3	_	_	_	1,716.3
05	303,895.3	346,592.2	42,696.9	86,758.9	59,472.9	84,924.0	25,451.1	25,564.1	_	_	14.8	1,707.2
06	305,459.8	347,885.6	42,425.8	95,068.4	61,702.6	85,509.0	23,806.4	31,664.9	_	_	_	1,700.9
07	338,622.1	380,985.5	42,363.3	59,819.2	20,875.1	85,496.7	64,621.7	37,251.0	_	_	_	1,693.1
08	337,380.3	379,678.8	42,298.6	59,524.8	20,319.2	85,565.6	65,246.4	37,518.4	_	_	_	1,687.3

	Baza monetare/ Monetary base (14+ 15+ 16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Detyrime ndaj korporatave të tjera depozituese/ Liabilities to other depository corporations	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money	Huatë/ Loans	Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Të tjera neto/ Other items net	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit/ Shares and other equity
	13	14	15	16	17	18	19	20	21
